



ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

RAPORTI FAKTOGRAFIK PËR IMPLEMENTIMIN E:

PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

RAPORTI FAKTOGRAFIK PËR IMPLEMENTIMIN E:

PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





Raporti faktografik për implementimin e Planit 3-6-9 nga 4 korriku 2017 – 17 prill 2018

Hyrje

Kriza e vazhduar politike në Republikën e Maqedonisë, e cila kulmoi në vitet 2015-2016, **shkaktoi lëvizje turbulente** në shoqërinë tonë **që lënë pasojë një ngadaslim të ndjeshëm po edhe regres në procesin euro- integrues** të vendit dhe përafrimin e saj drejt BE-së. Si rezultat i **Marrëveshjes politike të Përzahinos** u zbatuan **zgjedhjet Parlamentare në dhjetor të vitit 2016**. Ngjarjet që **paraprinë konstituimit** e përbërjes së re Parlamentare do të kujtohen sipas vendimeve dhe ngjarjeve të papreceden në historinë e shkurtër të dekomkracisë sonë.

Pas formimit të **shumicës së re Parlamentare dhe zgjedhja e Qeverisë së re**, prioriteti i parë i Qeverisë ishte, **vendi ti “kthehet” rrugës drejt BE-së**, sepse ai është **prioriteti strategjik** i Maqedonisë dhe se shumica e qytetarëve mbështesin anëtarësimin tonë në BE dhe NATO, si angazhim i ynë i vazhdueshëm **për të cilin nuk ka alternativë tjetër**.

Qeveria gjeti **marrëdhëniet të “ngrira”** me partnerët tanë strategjik, institucione “të kapura”. Detyra primare ishte **“ti shkrijmë”** marrëdhëniet me partnerët tanë dhe mbështetësit strategjik, ti “lirojmë” institucionet, administratën dhe shoqërinë në përgjithësi, që të krijojmë kushte për ta çuar vendin përpara. Ngecjet ishin të konsideueshme, devijimet – të thella. Duhej nga dikund të nisemi . Në **bashkëpunim dhe dialog me partnerët tanë strategjik**, ramë dakord për Planin që do të sigurojë gjurmim në rrugë dhe do të ishte fundament i reformave tona afatgjatë.

Këtë e shohim si proces crucial strategjik që duhet të **sigurojë afatgjatësi, gjithëpërfshirje dhe transparencë**, për arsye të thjeshtë se procesi nuk filloi por edhe nuk do të mbarojë me këtë Qeveri, përkundrazi, ajo është afatgjatë dhe kompleks dhe kërkon punë shumëvjeçare dhe investim. Gjithashtu, procesi nuk i takon vetëm Qeverisë, **por gjithë shoqërisë** dhe procesi duhet të jetë i dukshëm për të gjithë, me qëllim të krijojë atmosferë se çdokush **duhet të investoj në të dhe çdokush do të ketë përfitim nga ai**.

Kahja e reformave është e qartë dhe e definuar me **Programin për punë të Qeverisë 2017-2020, Marrëveshjen Politike të Përzahinos** dhe ndjek rekomandimet që dalin nga takimet e nivelit të lartë me përfaqësues të **institucioneve të BE-së**, në veçanti **Reformat Urgjente Prioritare**, si dhe rekomandimet e **Këshillit Evropian** respektivisht Komisioni i Venedikut, GREKO, OSBE/ODIHR, raportet e grupit të eksperteve kryesuar nga Pribe, si dhe konsultimet e gjëra me shoqëritë civile.

Interesat e qytetarëve janë kompasi ynë, pa dyshim, qytetraët duan **shtet stabil**, me institucione të forta demokratike dhe të kontrolluara nga qytetarët që do të sugurjnë jetë pa frikë dhe represion, duan zgjedhje ku vota do të jepet lire, pa shtypje dhe pa dhunë, duan ambien ekonomik ku aftësia konkurente do të jetë e rëndësishme e jo përkatësia politike, duan shtet ku shërbimet shëndetësore nuk do të trajtohen si privilegj për individë, por si detyrim i shtetit për të gjithë, duan shtet që do të ketë marrëdhënie miqësore me gjitha fqinjët dhe Qeveri që do të zgjidh gjitha çështjet e hapura, dhe jo e cila do ti përshkallëzojë dhe do ti nxisë animozitetet historike. Këto janë udhëzimet për reformat tona që do ti respektojmë në rrugën drejt BE-së.

Prej këtu definuam, harmonizuam dhe implementuam Planin 3-6-9 me të cilin u fokusuam në fillimin e ndryshimeve në tre muajt e para dhe krijimin e një klime më të përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve Lokale, si provim i pare për atë se a jemi serioz në deklarimin e qëllimit tonë për shoqëri plurale, demokratike, multietnike, me trajtim të barabartë për çdo individ dhe mundësi të barabartë për çdo



individ, më pas krijimin e një baze të forte ligjore dhe institucionale për zbatimin e reformave, si dhe rezultate konkrete dhe të dukshme të përpjekjeve reformuese deri te publikimi i Raportit të Komisionit Evropian, pas së cilës do të vazhdojmë të hapërojmë edhe më tej në procesin e integritimit në BE.

Pjesa e parë e Planit 3-6-9 u miratua në **04.07.2017**, ndërsa pjesa e dytë e Planit 3-6-9+ me **15.11.2017** i njëjti u definua në bashkëpunimi të gjërë ndër- institucional përmes një **proces transparent dhe gjithëpërfshirës**. Në definimin e masave në këtë Plan morën pjesë dhe kontribuan shërbimet profesionale të të gjitha institucioneve kompetente, Kuvendi, Qeveria, institucionet shtetërore, sektori civil dhe opozita. Është vendosur mekanizëm i plotë funksional operativ për koordinimin, monitorimin dhe ndjekje të implementimit në dy nivele, nivelin ministror dhe niveli i ekspertëve. Qeveria në nivel javor, në mënyrë të drejtpërdrejt monitoron statusin e realizimit dhe progresit.

Rezultatet e arritura deri në mbajtjen e zgjedhjeve lokale ishin një bazë solide për reforma më të thella, veçanërisht në fushat kryesore: gjyqësor, siguri dhe shërbimet e inteligjencës dhe reforma në administratën publike, pa neglizhuar fushat e tjera kyçe, mediat dhe sektorin civil.

Raportet e duhura janë përgatitur dhe janë dorëzuar rregullisht tek trupat përkatëse në Kuvend, Komisionin Evropian dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë, si dhe shoqërinë civile dhe publikun e gjerë. Pasqyrë faktografike e statusit të implementimit të masave të parapara në Planin 3-6-9 përfundimisht në 15.11.2017 është publikuar në veb faqen e SÇE-së dhe Qeverisë.

U mbajtën sërë debatesh të përgjithshme dhe tematike, tribina, takime me të gjithë palët e interesuar, si dhe brifingje dhe konferenca për shtyp, lidhur me përgatitjen dhe realizimin e Planit. Raporti përfundimtar faktografik në mënyrë transparente do të prezantohet dhe do të publikohet për opinionin e gjerë.

Theksojmë se me përfundimin e Planit 3-6-9, reformat që janë simbol i kësaj qeverie nuk përfundojnë, por ata vetëm sa po fillojnë dhe do të zgjasin derisa ti arrijmë qëllimet e caktuara dhe deri sa nuk sigurojmë një mjedis politik, demokratik, ekonomiko- social për ndërtimin e një shoqërie kohezive evropiane të drejtë dhe civile.

Gjithë ne jemi dëshmitarë se në periudhën e kaluar u krijua një klimë shumë pozitive rreth procesit të integritimit evropian, si në vend ashtu edhe në BE dhe në shtetet anëtare. Natyrisht që ky entuziazëm rriti pritjet si tek ne si Qeveri ashtu edhe tek qytetarët. Presim që të marrim rekomandim të pastër, dhe pastaj datë konkrete për fillimin e negociatave për aderim. Qeveria dhe administrata jonë janë plotësisht të përgatitur dhe të aftë të mbajnë barrën e kësaj sfide gjeneruese.



ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

RAPORTI FAKTOGRAFIK PËR IMPLEMENTIMIN E:

PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





1. Reforma në gjyqësor

Në pjesën e reformës në gjyqësor, Qeveria i pranoi vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, Komisionit të Venedikut dhe GREKO-s, si dhe rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Lartë për sundimin e së drejtës. Qeveria punon në mënyrë intensive dhe të përkushtuar në ndërtimin e gjyqësorit së pavarur, objektiv, profesional dhe efikas. Për këtë qëllim, Qeveria miratoi Strategjinë e re për reforma në sektorin e gjyqësorit e cila do të paraqes udhërrëfyes në të cilin do të lëvizin reformat në sektorin e gjyqësorit, kthimin e besimit tek institucionet, mundësimin e sigurisë juridike, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të veçanta të qytetarëve dhe ndërtimin e atmosferës së gjyqësisë së lirë, pa presione politike. U miratua ligji për ndërprerjen e validitetit të Ligjit për Këshillin për vërtetimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të gjykatësit dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor në përputhje me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, me të cilën kompetenca për procedurat disiplinore iu rikthye Këshillit Gjyqësor. U miratuan ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Mbrojtjen e denoncuesve të cilët miratuan me qëllim të përmirësimit të procedurës për raportimin dhe mbrojtjen e denoncuesve.

U zbatua pjesa e parë e verifikimit për funksionimin e sistemit AKMIS, në bazë të të cilit është përgatitur Raporti me rezultatet dhe i cili është dorëzuar për trajtim të mëtejshëm tek institucionet kompetente.

Në pjesën e reformave në **sistemin e burgjeve**, Qeveria pranoi vërejtjet dhe rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës pran Këshillit të Evropës dhe mori masa për përmirësimin e kushteve dhe kapaciteve të objekteve ndëshkimore, implementimin e sanksioneve alternative, si dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor dhe sigurisë, është vendosur në funksion shërbimi provues.

Miratimi i Strategjisë për reformima në sektorin gjyqësor për periudhën 2017-2022 me Plan Akcional

- Më 17.07.2017, Ministri i Drejtësisë formoi grup pune për shqyrtimin e Strategjisë për reforma në sektorin e drejtësisë me plan akcional. Në të njëjtën periudhë u themelua Këshilli për Reforma në Gjyqësor që ishte kompetent për koordinimin e përgatitjeve të Strategjisë dhe mandati i këtij Këshilli përfundoi me miratimin e Strategjisë.
- Në drejtim të sigurimit gjithëpërfshirje dhe transparencë në procesin e përgatitjes së Strategjisë, u mbajtën dy takime pune (27.07.2017 dhe 29.08.2017) me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve nga jurisprudenca dhe sektorit civil, në të cilin u prezantua draft - Strategjia për reforma në sektorin Gjyqësor. Gjatë përgatitjes, u morën parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.
- Më 28.11.2017, Qeveria miratoi Strategjinë për Reformë në Gjyqësor për periudhën 2017-2022 me një Plan akcional dhe e njëjta u botua në veb faqen e Ministrisë së Drejtësisë. Strategjia është përgatitur përmes një procesi të gjerë konsultativ dhe konsultime të rregullta me KE-në, ku të gjitha rekomandimet dhe udhëzimet e tyre në mënyrë të përshtatshme reflektohen në dokument.
- Strategjia e re jep udhëzime, kahje për përmirësim të sistemit të drejtësisë përmes tejkalimin e mangësive të karakterit institucional dhe normativ që rrejdhin përmes saj, por mbi të gjitha, ka parasysh problemin thelbësor të ndërhyrjes së ekzekutivit si dhe partizimin për regresin dhe



mosfunksionimin e Drejtësisë. Strategjia përcakton udhëzimet për krijimin e kushteve ligjore si dhe mjedisin për realizim të vërtetë të parimit të përgjegjësisë nga organet gjyqësore për vetë funksionim.

- Strategjia fokusohet në rishikimin e funksionimit të institucioneve të caktuara, në veçanti Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik, duke përfshirë deprofesionalizimin dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurën për përgjegjshmërinë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publikë, përforcimin e funksionimit të Prokurorisë Speciale Publike si institucion i pavarur në kuadër të Prokurorisë Publike në trajtimin e akteve në kompetencë të saj dhe ndjekjes së veprave penale të profilit të lartë “white collar crime”, rishqyrtimin e Sistemit të vlerësimit të cilësisë dhe efikasitetit në sjelljen e gjykatësve dhe prokurorëve publik, përforcimin e mekanizmave të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së gjykatësve dhe prokurorëve publik nëpërmjet një sistemi të vetë-rregullimit të shoqatave të tyre profesionale etj.
- Më 06.03.2018, u formua Këshilli për ndjekjen e implementimit të strategjisë në gjyqësor për periudhën 2017 -2022, me të cilën do të kryesojë Kryeministri. Anëtar të Këshillit janë Ministri i Drejtësisë, zëvendësministri i Drejtësisë, Prokurori publik, Prokurorit Special Publik, Avokati i Popullit, Kryetari i Shoqatës së Gjykatësve, përfaqësues i Gjykatës Supreme, një përfaqësues i Gjykatës së Apelit në Shkup, përfaqësues i Gjykatës së Apelit në Gostivar, përfaqësues i Prokurorisë Themelore Publike në Manastir, përfaqësues i Prokurorisë Themelore Publike në Shtip, Kryetari i Gjykatës themelore Shkup 1 - Shkup, Kryetari i Gjykatës themelore Shkup 2 - Shkup, përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve, profesor nga Fakulteti Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, profesor në Universitetin e Evropës Juglindore, përfaqësues i Blueprint grupi i shoqatave të qytetarëve për Gjyqësor, një profesor nga Fakulteti i Sigurisë - Shkup, pranë Universitetit "Shën Kliment Ohridski" në Manastir 2 avokatët nga Shkupi dhe Tetova, përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme, një përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe një përfaqësues i prokurorisë Publike.
- Më 28.03.2018, u mbajt seancë konstitutive e Këshillit për ndjekjen e implemetimit të Strategjisë për reforma në sektorit Gjyqësor.

Më 04.04.2018, u mbajt seanca e dytë e Këshillit ku u miratua Rregullorja e punës. U diskutuan propozimligjet për gjykatat dhe Këshill Gjyqësor me theks të veçantë në dispozitat ligjore të propozuara që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e gjyqtarëve si dhe mbrojtjen e tyre, por me qëllim të arritjes së pavarësisë më të madhe të gjyqësorit dhe kthimin e dinjitetit të gjykatësve.

- **Miratimi i Ligjit për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për vërtetimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të gjykatësit dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së**
 - Më 01.08.2017 u formua grupi Pune për përgatitjen e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së dhe përgatitjen e Ligjit për ndërprerjen vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për verifikimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për verifikimin e përgjegjësisë së gjykatësit.
 - Më 17.10.2017, Propozimligjet për mendim iu dërguan Komisionit të Venedikut, dhe më 8.12.2017 u miratua Mendimi për Ligjet
 - Me 18.10.2017, Propozimligjet, u publikuan në ENER
 - Me 15.11.2017, u miratuan nga Qeveria
 - Më 28 dhjetor 2017, Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin gjyqësor të RM-së u



miratua nga ana e Kuvendit. Qëllimi kryesor i Ligjit është rritja e transparencës në punën e Këshillit dhe të thjeshtëzohet procedura disiplinore për përcaktimin e përgjegjesisë së gjykatësit dhe në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare por në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare dhe njëkohësisht harmonizim me Propozimligjin për ndërprerjen e validitetit të Këshillit për përcaktimin e fakteve dhe fillimin e procedurën për përcaktimin e përgjegjesisë për gjyqtar.

- Më 11.01.2018 Ligji për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për verifikimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjesisë disiplinore të gjykatësit u miratua nga Kuvendi. Me këtë ligj pushon të vlejë Ligji për Këshillin e verifikimit të fakteve dhe ngritja e procedurës për përcaktimin e përgjegjesisë për gjykatësin dhe kompetenca për të kryer një procedurë disiplinore i kthehet Këshillit Gjyqësor.

Miratimi i Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësim të Ligjit të Gjykatat dhe Propozimligji për ndryshimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor,

- Më 31.08.2017 u formua grupi Punës për përgatitjen e Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Gjykatat dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor.
- Propozimligji i përgatitur për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë u publikua në ENER më 22-01-2018. Qëllimi kryesor i ligjit është të vendosen kritere matëse kualitative dhe kuantitative për vlerësimin e punës së gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave çdo dy vjet. Njëkohësisht, të kujdeset në barazpeshën e kritereve për sistemin e vlerësimit. Njëkohësisht u në dispozitat për anëtar të Këshillit me të drejtë vote, rangim të kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta, përforcimi i llogaridhënies së punës së Këshillit etj. Me ndryshimet e propozuara përforcet cilësia e kriterit të vlerësimit të gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave në raport me kuantitetin. Janë bërë ndryshime me përfshirjen e rekomandimeve të Komisionit të Venedikut dhënë në ndryshimet dhe plotësimet e fundit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor lidhur me funksionimin transparent të Këshillit. Gjithashtu, janë përfshirë edhe ndryshimet e parapara në Strategjinë për reforma në gjyqësor.
- Propozimligji i përgatitur për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat në pjesën e përgjegjesisë disiplinore dhe masave disiplinore u publikua në ENER më 24 janar 2018.
- Më 13.03.2018, Qeveria miratoi Propozimligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Propozimligjin për ndryshimin dhe plotësim të Ligjit për Gjykata
- Pas përfundimit të konsultimit me opozitën, të dy ligjet do t'i dërgohen Komisionit të Venedikut dhe Kuvendit.

• *Miratimi i Propozimligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e dëshmitarëve*

- Më 30 gusht 2017, Ministri i Drejtësisë formoi grup Punës për përgatitjen e propozimligjit për ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Propozim-ligji i përgatitur për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve u publikua në ENER më 16.10.2017
- Më 17.10.2017, propozimligji për mendim iu dorëzua Komisionit të Venedikut.
- Më 15.11.2017 u miratua nga Qeveria. Më 8.12.2017 u miratua mendimi i Komisionit të Venedikut për ligjin. Në bazë të mendimit, u përgatit një propozim-amendamenti dhe u zhvilluan diskutime të gjera me opozitën mbi propozim-ligjin.
- Qëllimi i ligjit të propozuar është të rregullojë plotësisht çështjen e mbrojtjes së dëshmitarëve



gjatë procedurat për ndjekjen e veprave penale të krimeve të lidhura dhe që dalin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve. Me miratimin e këtij Ligji do ti sigurohen kushte Prokurorisë Speciale Publike që të ketë autonomi të plotë në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale që dalin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve

- Ligji është në miratuar nga parlamenti me 12.04.2018. Pasi që përfunduan konsultimet me opozitën.

- **Përforcimi i kapaciteteve kadrovike të Avokatit të Popullit**

- Aktet e përgjithshme për sistematizimin e vendeve të punës të Avokatit të Popullit u miratuan nga Kuvendi më 11.07.2017, Në këtë drejtim, u miratuan edhe mjete financiare nga Ministria e Financave për shtatë (7) punësime të reja në Zyrën e Avokatit të Popullit deri në fund të vitit 2017. Në mënyrë plotësuese, në fillim të vitit 2018, është dhënë pëlqimi për sigurimin e burimeve financiare edhe për 3 persona për vitin 2018, respektivisht janë miratuar gjithsej 10 punësime të reja.

- **Miratimi i Propozimligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.**

- Me 01.08.2017, u formua grupi pune për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Propozimligji i përgatitur për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve u publikua në ENER me 01.11.2017, Gjatë përgatitjes së Ligjit, janë marrë parasysht vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit të Venedikut, të cilat janë bazë për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Eksperti i Këshillit të Evropës mori pjesë në disa takime të grupit të punës për përgatitjen e Ligjit për ndryshime në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve me komentet e tij. Lidhur me tekstin e Ligjit, eksperti i Këshillit të Evropës dha mendime pozitive.

- Më 21.11.2017, u mbajt një debat publik për Ligjin.

- Më 9.01.2018, propozimligji u miratua nga Qeveria.

- Më 20.02.2018, u miratua nga Parlamenti.

- **Mbështetje e plotë institucionale të punës së PSP-së, në përputhje me ligjet përkatëse.**

- Në periudhën raportuese u siguroa komunikim i pandërprerë dhe mbështetje institucionale për punën e PSP-së nga institucionet përkatëse shtetërore.

- Në përputhje me Strategjinë për reforma në sektorin gjyqësor 2017-2022, është planifikuar përforsim i punës së PSP-së si një institucion i pavarur në kuadër të PPRM. Kompetencat e tyre do t'i referohen rasteve që lidhen me rastet e korrupsionit që dalin nga materialet e përgjuara. Ndryshimet e reja në Ligjin për Prokurorinë Publike do të mundësohet vazhdimi i punës së Prokurorisë Speciale Publike. Në përputhje me këtë, PSP do të shndërrohet në një zyrë e PSP-së me kompetenca të pavarura brenda Prokurorisë Publike.

- **Miratimi i Propozimligjit për ndihmën Ligjore falas**

- Propozimligji është përgatitur në kuadër të IPA Twinning projektit "Përforcimi i sundimit të Ligjit".

- Më 28.11.2017, u publikua në ENER.

- Më 20.02.2018, Qeveria miratoi Propozimligjin për ndihmë juridike falas. Më 19.03. 2018. kaloi në leximin e parë në procedurën Parlamentare. Më 23.03.2018 u mbajt seanca publike.



Qëllimi i këtij ligji ishte që të sigurojë mundësi për më shumë qytetarë të kenë e mundësi, në veçanti ato që i përkasin kategorive të rrezikuara sociale për një gjykim me cilësi, të drejtë dhe gjykim fer. Pas debatit publik, propozimligji u tërhoq nga Kuvendi për arsye të nevojës për ndryshimeve të tekstit për më shumë se 53%.

- **Miratimi i Strategjisë së teknologjisë informatiko-komunikative në gjyqësor**

- Në bashkëpunim me ekspertët nga projekti IPA 2011 "Përforcimi i sundimit të ligjit", u përgatit strategjia për Teknologji informatike në sektorin e gjyqësorit nga 2018-2023. Ministria e Drejtësisë formoi grup pune me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës Supreme, Këshillit Gjykatësve, Gjykatës së Lartë Administrative, Gjykatës Administrative ,, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore, Prokurorisë Publike Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, Oda e Noterisë; Oda e Përmbaaruesve; Shoqata e Avokatëve dhe Oda e Ndërmjetësve, të cilët mbajtën 8 mbledhje.
- Strategjia e Teknologjisë nformatiko-Komunikative në Gjyqësor u miratua nga Qeveria më 20.02.2018.
- Me zbatimin e të TIK zgjidhjeve dhe sistemeve në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, qëllimi do të jetë rritja e qasjes, afateve kohore dhe lehtësime në përdorimin e shërbimeve gjyqësore për shfrytëzuesit, të përmirësohet cilësia e të dhënave, mbrojtja dhe siguria, si dhe bashkëpunimin me sisteme të tjera të gjyqësore, institucionet e Bashkimit Evropian, shtetet anëtare dhe organizatat ndërkombëtare.

- **Emërimi i udhëheqësit në Shërbimin e probacionit**

- - Është emëruar ushtrues detyre udhëheqës i shërbimit të probacionit.

- **Sektori provues të ekipohet me 16 të punësuar, oficerë të shërbimit të provës (9 në nivel qendror dhe 7 zyra lokale GJTH Shkup 1).**

- Një shumë prej 18 të punësuarve në DZS dhe IKN tani më janë vendosur dhe të ngarkuar me kryerjen e punës së probacionit prej të cilave 2 punonjës DZS u janë shpërndarë angazhimet e punës ti kryejnë në GjTh Shkup 1, 4 punonjës në DZS janë shpërndarë zyrat e DZS përmes së cilës do të zbatohet mbikqyrja elektronike të të gjithë territorit të vendit, dhe 13 të punësuar në sektorin e resocializimit të IKN janë të vendosur për të kryer punën e probacionit për lirim me kusht. Në mars prill 2018 3 të punësuar në sektorin për siguri nga çdo IKN (33 persona) do të trajnohen në vendosjen dhe heqjen e pajisjeve për mbikëqyrjen elektronike të këtyre aktivitete që do të kryhet në terren.

- **Fillimi me punë i zyrës së Provës në rajonin e Gjykatës Themelore Shkup 1 si pilot projekt**

- Filloi me punë Zyra e probacionit në Gjykatën Themelore Shkup 1, e cila është e pajisur plotësisht me mobilje dhe pajisje kompjuterike për dy punonjës nga Drejtoria për zbatimin e sanksioneve janë alokuar për të kryer aktivitetet e punës në këtë zyrë.

- Në periudhën e ardhshme, do të vazhdojë vendosja e zyrave lokale të probacionit në rajonin e 5 gjykatave themelore me kompetencë më të zgjeruar (Shtip, Veles, Tetovë, Strumicë dhe Prilep).



- ***Të evidentohet zbatimi i rekomandimeve të Komitetit kundër torturës të Këshillit të Evropës***
 - Drejtoria për zbatimin e sanksioneve ka përgatitur Plan Akcional me masa, afate kohore dhe status të realizimit të Rekomandimeve të Komitetit të Këshillit të Evropës kundër torturës, me të cilin u evidentuan rekomandimet dhe sistemi për monitorim në realizimit të tyre.
- ***Transferimi i kompetencave për kujdesin shëndetësor të burgosurve nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë***
 - Në proces është procedura e marrjes së personelit shëndetësor nga IKN i Idrizovës dhe Burgut të Shkupit në Entin e Shëndetit Publik në Shkup është. Për momentin në Institucionin korrektues ndëshkimor Idrizovë janë punësuar 5 punonjës të shëndetësor (mjek i përgjithshëm, psikiatër specialist, mjek i përgjithshëm, dentist i diplomuar, teknik bioteknologjik - laborator). Në burgun e Shkupit janë 3 të punësuar shëndetësorë (mjek i përgjithshëm, dentist i diplomuar, teknik i laboratorik). Në mënyrë plotësuese, buxheti i institucionit shëndetësor Shkup është rritur me 21 milion denarë.
 - Lidhur me transferimin e kujdesit shëndetësor në Institucionin korrektues ndëshkimor, Ministria e Shëndetësisë bëri ndryshime në statusin e institucioneve relevante shëndetësore. Në proces është procedura për marrjen e personelit shëndetësor për pjesën tjetër..
- ***Raporti i parë mbi inspektimin e funksionimit të sistemit AKMIS me konstatime të përcaktuara për keqpërdorime të mundshme me rekomandime***
 - Me 22. 09.2017 u formua grupi punues për shqyrtim në funksionimin e sistemit të informacionit (AKMIS) me qëllim të qasjes së autorizuar në AKMIS për qasje në të dhënat dhe kontroll të funksionimit të deritanishëm të sistemit informatik, përdorimi i drejtë, shpërndarje automatike, identifikimin e keqpërdorimit eventual dhe përgjegjësisë si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të rregullores së Gjykatës. Grupi përbëhej nga 8 persona (MD, IT persona nga MD, GjTh Kavadar, KGjRM, GJA Shkup, gjykatës nga GjTh Kavadar, GJA Shkup).
 - Përfundoi pjesa e parë e inspektimit të funksionalitetit të sistemit informativ dhe mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të Rregullores së Gjykatës në gjykata. Inspektimi u krye nga grupi punues që u formua nga Ministria e Drejtësisë, e përbëhet nga ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë, gjykatës dhe ekspertë të informatikës
 - Inspektimi i parë u zbatua në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, më 5 dhe 10 tetor 2017. Në Gjykatën e Apelit të Shkupit, inspektimi u krye më 9 nëntor 2017. Në Gjykatën Supreme, inspektimi u krye më 17 nëntor 2017. Lënda inspektimi në të tri gjykatat ishin procedurat për funksionimin e AKMIS, orari vjetor i gjykatësve, procedurën për përjashtimin e gjyqtarit nga shpërndarja automatike dhe rialokim i lëndëve, të gjitha vendimet për ndarjen manuale të lëndëve.
 - U konstatuan mospërputhje në zbatimin e Ligjit për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykatë dhe rregullores së Gjykatës, si dhe mospërputhshmëria e përdorimit të AKMIS në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup dhe në Gjykatën Supreme.
 - Në Gjykatën e Apelit në Shkup u konstatua se Ligji për Menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykatë dhe Rregulloren e Gjykatës zbatohen, AKMIS implementohet dhe përdoret rregullisht, përveç në pjesën drejtuese të gjyqit.
 - Një pjesë e raportit është prezantuar në media, e publikuar në veb faqen e Ministrisë së Drejtësisë. Raporti i plotë është një dokument i klasifikuar i nënvizuar në një shkallë të besueshmërisë dhe është përcjellë në procedurat e mëtejshme të institucioneve kompetente (Prokuroria Publike, Këshilli Gjyqësor).
 - Deri në fund të prillit 2018, Komisioni do të përfundojë verifikimin e AKMIS në gjykatat e tri



PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018



gjykatave të tjera të apelit (Shtip, Manastir, Gostivar) si dhe 8 gjykatat themelore (Shtip, Gostivar, Manastir, Tetovë, Prilep, Veles, Kumanovë, Kriva Pallankë, Ohër) Pasi të përfundojë verifikimi, parashihet të përgatiten rekomandimet për tejkalimin e dobësive të identifikuara në sistemin AKMIS, si dhe të vazhdojë me auditin e rregullt të të njëjtit.



ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

RAPORTI FAKTOGRAFIK PËR IMPLEMENTIMIN E:

PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018



SEKRETARIATI PËR ÇESHITJE EVROPIANE



2. Reforma e shërbimeve të sigurisë dhe të inteligjencës

Qeveria beson se reforma e shërbimeve të sigurisë dhe telegjencës është më se e nevojshme. Duke pasur parasysh se kjo është një reformë gjithëpërfshirëse, Qeveria është e përkushtuar që të sigurojë një debat transparent dhe gjithëpërfshirës, në të cilin procesi i konsultimit do të zbatohet siç duhet. Në këtë drejtim, formoi një grup pune i përbërë nga përfaqësues të institucioneve relevante, opozita dhe ekspertë, të cilët kanë përgatitur planin e masave dhe aktivitetëve për tejkalimin e dobësive në sistemin aktual të ndjekjes së komunikimit dhe në interes të garantimit të ligjshmërisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurinë e shtetit dhe të qytetarit. Reforma do të zbatohet në mënyrë konkrete, në përputhje me dinamikën e krijuar për ndryshimet e nevojshme, me qëllimin përfundimtar të rikthimit të besimit në sistem.

Në fushën e **reformës së policisë** ka filluar procesi i krijimit të një mekanizmi të jashtëm të pavarur për kontrollin e punës së policisë, i cili duhet të sigurojë paanshmërinë në trajtimin e rasteve në rastet kur ka dyshime se krimet janë kryer nga punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- **Fillimi i një diskutimi gjithëpërfshirës në Kuvend për përzgjedhjen e modelit për reformën e sistemit për ndjekjen e komunikimeve.**
 - Pas konsultimeve intensive brenda Ministrisë së Brendshme mbi modelin për reformën e sistemit të inteligjencës dhe sigurisë, ajo u zgjodh nga Qeveria më 12 shtator 2017.
- **Miratimi i Planit për zbatimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të lartë për çështjet sistematike të sundimit të ligjit në lidhje me ndjekjen e komunikimeve (2015/2017) me një listë të akteve ligjore, masave administrative dhe teknike si dhe implikimeve financiare,**
 - Qeveria në 31.10.2017 miratoi vendim për të formuar një grup pune të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të përfshira, persona profesionit dhe ekspertë si dhe përfaqësuesve të dy komisioneve parlamentare për të mbikëqyrur punën e UBK dhe AB dhe mbikëqyrjen mbi zbatimin e Masave të posaçme hetimore për përgjimin e komunikimeve. Grupi i punës ka përgatitur Planin për Zbatimin e Rekomandimeve të ekspertëve të Komisionit Evropian të udhëhequr nga R. Pribe për çështjet sistematike të sundimit të ligjit lidhur me monitorimin e komunikimit (2015/2017), dhe do të koordinojnë dhe monitorojnë zbatimin e saj të mëvonshëm.
 - Plani për zbatimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të lartë për çështjet sistematike të sundimit të ligjit në lidhje me monitorimin e komunikimeve (2015/2017 të miratuar nga Qeveria më 27 nëntor 2017).
 - Më 18 dhjetor 2017. u zhvillua një debat për reformat e Ministrisë së Brendshme dhe mekanizmat e mbikëqyrjes për kontrollin e ndjekjes së komunikimeve të organizuara nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, ku morën pjesë disa organizata qytetare. Ministria e Brendshme organizoi 3 takime me operatorët, si dhe 3 takime me organizatat e shoqërisë civile. Katër debate / forume publike u organizuan nga OSHC-të.
- **Miratim nga Qeveria të pakos me ligje të nevojshme për reforma në sistemin e ndjekjes së komunikimit**
 - Me qëllim të tejkalimit të vërejtjeve nga grupi i ekspertëve të lartë për çështjet sistematike të sundimit të ligjit. Grupi i punës përgatiti tekstet e mëposhtme ligjore në fushën e monitorimit të komunikimit:



- Ligji për përgjimin e komunikimeve, (statusi: u miratua nga Parlamenti)
 - Ligji për Agjencinë Teknike Operacionale (ATO), (statusi: u miratua nga Parlamenti)
 - Ligji për ndryshimin e Ligjit për komunikime elektronike (statusi: i miratuar nga Kuvendi)
 - Ligji për ndryshimin e Ligjit për procedurë penale (statusi: në procedurë parlamentare, shumica 2/3) dhe
 - Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Informacionin e Klasifikuar (statusi: i miratuar nga Kuvendi).
- Para se të hyjnë në procedurën qeveritare, ato u botuan në ENER më 24 nëntor 2017. E tërë seria e ligjeve u miratua nga Qeveria në seancën e saj më 26.12.2017.
- Paralelisht me hartimin e rregulloreve, grupi i punës ka mbajtur vazhdimisht takime me ekspertë, organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të operatorëve, me qëllim prezantimin e modelit kombëtar për tejkalimin e mangësive të identifikuara në fushën e monitorimit të komunikimit dhe marrjen e propozimeve dhe sugjerimeve të tyre.
- Në periudhën prej 11-15.12.2017, 4-5.01.2018g. dhe 30-31 janar 2018. U realizuan Misionet e ekspertëve me një ekspert të Komisionit Evropian, i cili ishte gjithashtu anëtar i grupit të ekspertëve të lartë
- Paketa e propozuar e ligjeve i referohet si në vijim:
- Me **propozim-ligjin për përgjimin e komunikimeve** rregullohet: procedura për zbatimin e masave hetimore të veçantë: monitorimin dhe inçizimin e telefonit dhe komunikimeve të tjera elektronike; kushtet dhe procedurat për zbatimin e masave për monitorimin e komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit; detyrimet për Agjencinë Operacionale-Teknike si dhe operatorët, si dhe mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve. Detajisht e elaboruar procedura për zbatimin e masave së veçanta: monitorimin dhe regjistrimin e telefonit dhe komunikimeve të tjera elektronike, duke filluar me kërkesën për lëshimin e urdhrat për zbatimin e tij, përmbajtjen e saj, lëshimin e një urdhëri për të zbatuar masë të veçantë, duke përfshirë edhe shembujt anonime për nevojat e agjencisë teknike operative si dhe nevoja për mbikëqyrje dhe kontroll, roli i prokurorit publik gjatë zbatimit të masës, përgjegjësia e personave të autorizuar nga Policia Gjyqësore për përgatitjen e raporteve të informojë prokurorin publik, si dhe ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave të mbledhura me masë veçantë hetuese. Kushtet dhe procedura për zbatimin e masave për monitorimin e komunikimeve rregullohen gjithashtu me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit. Gjithashtu, mënyra e mbikëqyrjes nga organet mbikëqyrëse dhe të kontrollit për zbatimin e masave për përgjimin e komunikimeve është përpunuar saktësisht. Gjithashtu është përcaktuar se mbikëqyrje për të ndjekur komunikimet që zbatohen nga autoritetet kompetente dhe mbikëqyrjen e operatorëve dhe ATO nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Këshilli për Kontrollin Civil, Drejtoria për Siguri të Informacionit të Klasifikuar, Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë.
- **Propozim ligji për Agjencinë Teknike-Operacionale** rregullon krijimin e ATO-së, kompetencat, administrimin, të drejtat dhe detyrimet e punës së punëtorëve në ATO, mbikëqyrjen e ekspertëve që ATO e kryen mbi punën e operatorëve dhe financimin e saj. Ajo parashikon krijimin e agjencisë teknike-operative, si organ i pavarur shtetëror që siguron lidhjen teknike ndërmjet operatorëve dhe autoritetet kompetente. Agjencioni tekniko-operativ ka për qëllim të veprojë si një organ ndërmjetës që përcakton kalimin teknik ndërmjet operatorit dhe autoriteteve kompetente, pa mundësinë për të regjistruar komunikimin e ndjekur. Lidhja teknike ofrohet vetëm në bazë të një urdhri të gjykatës, me qëllim të kryerjes së monitorimit të komunikimeve në pajtim me Ligjin për përgjimin e komunikimeve
- **Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për komunikime elektronike**



përcakton kohëzgjatjen e saktë në të cilën operatorët janë të detyruar të ruajnë të dhënat për vendndodhjen aktuale gjeografike, fizike apo logjike të pajisjeve terminale të abonentëve apo përdoruesve të tyre, mjaftueshëm për të arritur objektivat e ligjit të komunikimeve elektronike dhe përgjimin e komunikimeve, pa cenuar të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve kanë të bëjnë me integritetin moral.

- **Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për informata të klasifikuara** do të mundësojë procedurën për verifikimin e nivelit të tretë të njerëzve të punësuar në organet mbikëqyrëse që mbikëqyrin zbatimin e masave për të monitoruar komunikimet, si dhe ekspertët e akredituar kombëtarë dhe ndërkombëtar teknik të angazhuar nga këto organe, në përputhje me Ligjin për përgjimin e komunikimeve të zgjasë një muaj nga data e paraqitjes së kërkesës. Ky projektligj parashikon një kontroll të sigurisë në shkallë të dytë për personat para fillimit të punësimit në ATO sipas Ligjit për ATO, të zgjasë një muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

- **Miratimi nga Qeveria e paketës së ligjeve të nevojshme për krijimin e mekanizmit të jashtëm**

- Propozimi për modelin për mekanizmin e pavarur të jashtëm për monitorimin e punës së policisë u miratua nga Qeveria më 12 shtator 2017,
- Në drejtim të krijimit të një mekanizmi të jashtëm për mbikëqyrjen e punës së Ministrisë së Brendshme, u përgatitën ndryshimet e mëposhtme ligjore:
 - Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat: në procedurën parlamentare, shumica 2/3)
 - Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Statusin e Prokurorisë Publike: në procedurën parlamentare, shumica 2/3),
 - Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Prokurorinë Publike (u miratua nga Parlamenti),
 - Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punë të brendshme (statusi: i miratuar nga Kuvendi),
 - Projektligji për ndryshimin e Ligjit për policinë (statusi: miratohet nga Kuvendi) dhe
 - Projektligji për ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve (statusi: miratohet nga Kuvendi) dhe
 - Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Avokatin e Popullit (statusi: i miratuar nga Kuvendi)

Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Avokatin e Popullit u miratua nga Qeveria më 4 janar 2018. ndërsa projektligjet e mbetura u miratuan nga Qeveria më 26.12.2017.

- Pakoja e propozuar e ligjeve vazhdon në vijim;
- **Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Gjykatat** parashikon një kompetencë të re të një departamenti gjyqësor të specializuar për gjykime në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë në Gjykatën Themelore Shkup I - Shkup për vepra penale të kryer nga zyrtarët e policisë dhe zyrtarët e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit.
- **Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Prokurorinë Publike** parasheh krijimin e një njësie të veçantë për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të kryera nga personat me autorizime policore dhe pjesëtarët e Policisë së Burgjeve në Prokurorinë Themelore Publike për Prokurorinë e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionin. Në të njëjtën kohë, është paraparë që departamenti të ketë një shërbim të posaçëm profesional dhe hetues të prokurorive publike.



PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018

Prokurorët dhe kreu i departamentit cakton prokurorin e Prokurorisë Publike për krimin e organizuar dhe korrupsionin, por jo më pak se 4 vjet. Në të njëjtën kohë definohet se çfarë është nënkupton një person me kompetenca policore, pasi ai është një polic, një zyrtar i autorizuar për Siguri dhe Kundërzbulim me kompetenca policore, pjesëtarët e policisë financiare, Me ligj personat e autorizuar në Drejtorisë doganore të autorizuar të cilët punojnë në zbulimin e krimeve dhe zyrtarëve të autorizuar persona të Ministrisë së Mbrojtjes që punojnë në zbulimin dhe hetimin e krimeve.

- **Projektligji për ndryshimin e Ligjit për prokurorinë publike** përcakton: titujt e punonjësve, procedurat për punësim dhe ngritje në detyrë në Departamentin për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të kryera nga personat me autorizime policore dhe pjesëtarët e policisë së burgjeve, sigurimi dhe pagat, si dhe përgjegjësia disiplinore dhe materiale e punonjësve të Njësisë së sapoformuar,
- **Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punë të brendshme** parashikon pas pranimit të kallëzimit penal apo informacion se punonjësit e Ministrisë, me statusin e një oficeri të policisë apo zyrtari i autorizuar i Sigurisë dhe Inteligjencës me kompetenca policore ka kryer një krim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare apo veprim jashtë detyrës duke përdorur një kërcënim serioz, forcë ose detyrim me pasojë vdekjen, lëndime të rënda trupore, lëndimet trupore, burgim të paligjshëm, tortura dhe trajtime mizore, çnjerëzor ose poshtërues nëse ligji parashikon ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare Ministria do të njoftojë menjëherë Departamentin për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e kryera nga njerëzit me kompetenca të policisë dhe pjesëtarëve të policisë së burgjeve në Prokurorin Publike Themelore për ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. Në këtë kuadër, Ministria së bashku me njoftimin, të paraqesë në Departament të gjitha burimet e informacionit në lidhje me veprën penale, kryerësit dhe viktimës dhe burime të tjera të informacionit të cilat janë të disponueshëm.
- **Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë** parasheh që pas marrjes së një kallëzimi penal ose informacion se një oficer i policisë ka kryer një krim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare apo veprim jashtë detyrës zyrtare duke përdorur një kërcënim serioz, forcë me pasojë vdekje, lëndime të rënda trupore, lëndimet trupore, ndalim i paligjshëm, tortura dhe trajtimi i egër çnjerëzor ose poshtërues njoftëse ligji e parashikon ndjekjen ex officio Ministria është e detyruar të njoftojë menjëherë Departamentin për hetim dhe ndjekje penale për krimet e kryera nga njerëzit me kompetenca të policisë dhe pjesëtarëve të policisë së burgut në Zyrën e Prokurorit Publik për Krimit të Organizuar dhe Korrupsion, njësia organizative e Ministrisë përgjegjëse për kontrollin e brendshëm dhe standardet profesionale ndërmarrin veprime për fillimin e një procedure disiplinore për atë punonjës, me miratimin e prokurorit publik nga Departamentit për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale dhe veprat penale të kryera nga personat me kompetenca policore dhe pjesëtarëve të policisë së burgut në Zyrën e Prokurorit Publik për krimin e organizuar dhe korrupsionit, i cili do të përgatisë një raport me mendim për Ministrinë e Brendshme.
- **Propozim ligji për ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve** parashikon detyrim pas marrjes së informacionit për ekzistimin e arsyeve për dyshim se një anëtar i policisë së burgut kryer një vepër penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo veprim jashtë detyrës zyrtare me forcë me pasojë vdekjen, lëndime të rënda trupore, lëndime trupore ose privimi i kundërligjshëm nga liria nëse ligji parashikon ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare, institucionet penale dhe korrektuese ose Drejtoria për Ekzekutimin e sanksioneve pa vonesë të njoftojë Departamentin për hetim dhe ndjekje penale për krimet e kryera nga njerëzit me kompetenca policore dhe pjesëtarëve të policisë së burgut në Prokurorit Publik për ndjekje të krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.
- **Propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit** lejon krijimin e një trupi të veçantë të jashtëm, si sistem shtesë korrigjues të hetimit të krimeve të kryera nga zyrtarët e autorizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe pjesëtarëve të policisë së



burgjeve. Për këtë qëllim, është paraparë në kuadër të Avokatit të Popullit të krijohet një njësi e veçantë organizative - një mekanizëm për kontrollin civil. Gjegjësisht, njësi organizative do të ketë tre përfaqësues nga organizatat joqeveritare së bashku me Avokatin e Popullit për të ndërmarrë veprime dhe masa për të siguruar mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave, të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e interesave të tyre në të gjitha procedurat përmes hetimeve efikase dhe transparente, në vepra penale dhe veprime të tjera të paligjshme të kryera nga punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjatë zbatimit të autorizimeve policore dhe nga pjesëtarët e policisë së burgjeve. Zgjedhja e organizatave joqeveritare kryhet nga Kuvendi në bazë të një njoftimi publik që publikohet çdo vit. Pastaj, tre organizatat joqeveritare të përzgjedhura do të emërojnë një përfaqësues për një anëtar të jashtëm në Avokatin e Popullit - një mekanizëm i kontrollit civil me një mandat njëvjeçar

- Për të siguruar zbatim të suksesshëm të mekanizmit të jashtëm do të përgatitet një Plan akcional për krijimin e mekanizmit të kontrollit të jashtëm të punës së njerëzve me kompetenca policore dhe pjesëtarëve të policisë së burgjeve. Ai përmban masa specifike, institucionet përgjegjëse dhe afatet për zbatimin e tyre, mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e tyre do të sigurohen nga buxheti i institucioneve kompetente
- Në përgatitjen e saj të përfshirë ishin të gjitha institucionet që kanë kompetenca në zbatimin e konceptit të përgjithshëm të mekanizmit të jashtëm: Prokuroria publike, Prokurorit Publik themelore për Krim të Organizuar dhe Korrupsion, Avokatin e Popullit, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e doganave, policisë financiare, Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, Ministria e Financave dhe Ministria e shoqërisë Informatike dhe administrative .
- - Plani i Veprimit u miratua nga Qeveria më 03.04.2018.
- Ai përbëhet nga 3 pjesë: Themelimi i Njesisë për hetim dhe ndjekje penale për krimet e kryera nga njerëzit me kompetenca policore dhe pjesëtarëve të policisë së burgut në Prokurorit Publik themelore për Krim të Organizuar dhe Korrupsion; krijimi i një njësie të veçantë organizative - mekanizmin e kontrollit civil të Avokatit të Popullit, si dhe ndryshime të tjera ligjore (ligjeve dhe akteve nënligjore) nga institucionet me personat që kanë kompetenca policore dhe pjesëtarëve të policisë burgjeve.
- **Formimi dhe emërimi i anëtarëve të Komitetit Kombëtar për Zgjidhjen e Ekstremizmit dhe Radikalizimit të Dhunshëm që çon në Terrorizëm.**
 - Në seancën e mbajtur më 04.08.2017. Qeveria miratoi një vendim për emërimin e anëtarëve, zëvendës anëtarëve dhe sekretarëve të Komitetit Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit. Vendimi u publikua në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr.98, datë 01.08.2017.
- **Emërimin e një Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe të zëvendësve të tij.**
 - Qeveria në seancën e saj të mbajtur më datë 4.8.2017. miratoi një vendim për emërimin e Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe vendimet për emërimin e Zëvendës Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Zëvendës Koordinatorin Kombëtar për Luftën kundër Terrorizmit. Vendimet u publikuan në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 110 nga 14.8.2017.



- **Organizimi i tribunave publike me përfaqësues të sektorit civil, vetëqeverisjes lokale, bashkësive fetare, ekspertë dhe shkenctarë me qëllim të përcaktimit dhe zbatimit të masave të duhura për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.**
 - Vijon përgatitja e projektit në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë për të organizuar konsultime publike kombëtare. Projekti pritet të realizohet në tri faza nga janari deri në prill 2018. Faza 1: tryeza të rumbullakëta tematike në dhjetë komuna të ndryshme; Faza e dytë: seminar dy ditor; Faza 3: forume publike ose forume për ngritjen e vetëdijes për të gjithë aktorët socialë. Më 13 dhe 14 shkurt 2018 në Shkup dhe Tetovë u mbajtën debate publike me përfaqësues të sektorit civil dhe vetëqeverisjes lokale, ku u prezantuan konceptet e projekt strategjive për parandalimin nga ekstremizmi i dhunshëm dhe lufta kundër terrorizmit.
- **Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë për Luftimin e Terrorizmit me Planin e Veprimit**
 - Strategjia Kombëtare e Republikës së Maqedonisë për Luftimin e Terrorizmit me një Plan Veprimi u miratua nga Qeveria më 6 mars 2018.
- **Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm me një Plan Veprimi**
 - Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare të Republikës së Maqedonisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm me një Plan Veprimi më 6 mars 2018
 -
- **Shënimet në mbledhjet e Komitetit Kombëtar për Luftën Kundër Terrorizmit**
 - Në tetor dhe nëntor 2017, USAID-i organizoi një trajnim tematik për të përmirësuar njohuritë e Koordinatorit dhe Zëvendës Koordinatorëve me një studim të hollësishëm të koncepteve dhe manifestimeve të ndryshme të problematikave të ekstremizmit të dhunshëm dhe njohjes me programet tashmë të provuara dhe të suksesshme dhe politikat për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në nivel global, rajonal, kombëtar, lokal dhe individual.
 - Në periudhën prej 07-09.11.2017, Në Shkup u mbajt simulim i ushtrimit „luftëtarët e huaj terroristë: Promovimi Parandalimi dhe rezistenca“, organizuar nga Ambasada e SHBA, OSBE dhe konsorciumi „Partneritet për Paqe“, në bashkëpunim me Qeverinë. Qëllimi i simulimit detyrës ishte të bëhen program rekomandime që do ti mbështesin institucionet shtetërore dhe partnerët rajonal në zhvillimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në parandalimin e sfidave aktuale dhe të ardhshme të sigurisë, si në vend poashtu edhe në rajon. Vlerësimet e Komitetit janë se rekomandimet nga deklaratat përmbyllëse të ushtrimit duhet të përdoren si bazë për nisjen e përgatitjes së strategjive dhe planeve akcionale për t’iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit.
 - Më 15.11.2017, Koordinatori Kombëtar dhe Zëvendës Koordinatorët së bashku me USAID-in organizuan një tryezë të rumbullakët për anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komitetit Kombëtar. Qëllimi i kësaj tryeze ishte prezantimi i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre, përvojat e tyre në lidhje me përballimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, shpjegojnë se si e kuptojnë rolin e tyre në punën e Komitetit dhe se si ata mund të angazhohen në menyrë me aktive në përgatitjen e dokumenteve strategjike.



ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

RAPORTI FAKTOGRAFIK PËR IMPLEMENTIMIN E:

PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





3. Kuvendi

Në pjesën e punës së Kuvendit, Qeveria u fokusua në mbështetjen e plotë të të gjitha masave për kthimin e ambientit demokratik në këtë institucion kryesor, përmes dialogut politik dhe bashkëpunimit me të gjitha partitë parlamentare dhe veçanërisht me opozitën. Qeveria do të japë kontributin e vet për sigurimin e kushteve për implementim të plotë të Rekomandimeve për të cilat u dakorduan pas ngjarjeve të padëshiruara nga 24/12/2012, lidhur me ngjarjet e dhunshme nga 27/04/2017. Qeveria, partnerët e koalicionit dhe shumica në Kuvend, në bashkëpunim të hapur dhe të sinqertë me opozitën, kujdeset që funksioni mbikëqyrës i Kuvendit dhe trupave të Kuvendit mbi punën e Qeverisë dhe shërbimet e saj të sigurisë dhe zbulimit, të jetë i rregullt dhe në mënyrë rutinore, me shkallë më të lartë të mundshme të transparencës dhe përfshirjes së përfaqësuesve nga shoqëria civile.



- ***Për të forcuar llogaridhënien, Qeveria i propozon Kuvendit, përveç atyre të rregullta, që të përfshijë çështje tematike parlamentare, një herë në javë për një orë***
 - Më 16.08.2017 Kryetari i Qeverisë i dërgoi letër Kryetarit të Kuvendit, në të cilën theksohet gatishmëria e qartë e Qeverisë për mbajtjen e pyetjeve javore, tematike të deputetëve në kohëzgjatje prej një orë e gjysmë, në kohë dhe në formatin që është më i përshtatshëm dhe në pajtim me procedurat e brendshme të Kuvendit.
 - Qeveria iu përgjigj kërkesave të Kryetarit të Komitetit të Politikës së Jashtme për diskutim mbi projekt-marrëveshjen për miqësinë dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Bullgarinë. Më 18 korrik 2017, Kryetari i Qeverisë shtroi marrëveshjen në një sesion të mbyllur të komisionit.
 - Qeveria, përkatësisht partnerët e koalicionit dhe shumica në Kuvend, janë të përgatitur që në bashkëpunim të hapur dhe të sigurtë me opozitën, të kujdesen që funksioni mbikëqyrës i Kuvendit dhe i trupave të Kuvendit mbi punën e Qeverisë dhe shërbimet e saj të sigurisë dhe zbulimit, të jetë i rregullt dhe në mënyrë rutinore.
 - Në nenin 122, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit është përcaktuar se trupat punues munden që në mbledhjet e veta të ftojnë persona profesionalë dhe ekspertë nga sfera të caktuara dhe nga institucione dhe shoqata tjera për t'u prononcuar për çështje që shqyrtohen në mbledhjet e trupave punues. Kjo mundësi edhe po aplikohet në punën e deritanishme të trupave punues. Gjithashtu, Qeveria obligohet dhe pranon elaborim të detyrueshëm të propozimligjeve, para trupave të Kuvendit, në nivel të ekspertëve.
 - Në shtator, KRM-ja e përtëriu Grupin parlamentar ndërpartiak për të drejtat e personave me handicap (GNP), në bashkëpunim me Polio plus. Gjithashtu, për herë të parë, Kuvendi vendosi Klub për çështje dhe politika të të rinjve. Klubi është trup joformal, i formuar nga anëtarë të të gjitha partive parlamentare qëllimi i të cilit është realizimi i interesave të të rinjve në vend, në bashkëpunim me organizatat e të rinjve, grupet joformale të të rinjve dhe brezat e rinj partiakë.
- ***Forcimi i rolit dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në punën e organeve punuese të Kuvendit***
 - Me qëllim që të jetë i hapur për sektorin joqeveritar, Kuvendi ishte nikoqir i dy evenimenteve të organizuara me organizatat civile. Në vijim e sipër është aktivimi i veglës së re, të ashtuquajtur "e-Dritare" qo do t'u mundësojë qytetarëve të paraqiten për prezencë në seancat plenare. Gjithashtu, u shtua edhe një vegël e re përmes së cilës qytetarët do të mund të njoftohen veçanërisht me aktivitetet e deputetëve të shënuar me emrin "Takime".
 - Në shtator, KRM-ja e përtëriu Grupin parlamentar ndërpartiak për të drejtat e personave me handicap (GNP), në bashkëpunim me Polio plus. Gjithashtu, për herë të parë, Kuvendi vendosi Klub për çështje dhe politika të të rinjve. Klubi është trup joformal, i formuar nga anëtarë të të gjitha partive parlamentare qëllimi i të cilit është realizimi i interesave të të rinjve në vend, në bashkëpunim me organizatat e të rinjve, grupet joformale të të rinjve dhe brezat e rinj partiakë
 - Më 23 shkurt 2018, në Parlament u formua një grup parlamentar ndërpartiake për të drejtat e personave LGBTI me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të pjesëtarëve të këtij komuniteti, pavarësisht nga orientimi seksual dhe identiteti gjinor.
 - Nga ana tjetër, në një letër të Kryeministrit, Qeveria obligohet se shumica parlamentare do të angazhohet edhe për përfshirje më të madhe adekuate të shoqërisë civile në diskutime në trupat punues.
 - Qeveria angazhohet në mënyrë aktive edhe për përfshirjen e Kuvendit në reformën e



shërbimeve të zbulimit dhe sigurisë.

- Qeveria gjithashtu obligohet për mbështetje të plotë për masat me qëllim kthimin e ambientit demokratik në atë institucion kryesor, përmes dialogut politik dhe bashkëpunimit me të gjitha partitë parlamentare, përfshirë edhe opozitën.
- **Rritja e rolit të opozitës në punën e Kuvendit duke mundësuar shumicën dhe duke kryesuar në një numër të konsiderueshëm të komisioneve parlamentare.**
 - Në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur më 14.07.2017 u miratua vendimi për formimin e Këshillit Nacional për Eurointegritet. U zgjodh kryetari (nga opozita) dhe zëvendëskryetari. U formuan 21 komisione, prej tyre me 10 kryeson opozita (VMRO-DPMNE, PSM, BESA), e me 11 kryeson pozita (LSDM, BDI, përfshirë edhe deputetët e pavarur). Në mbledhjen e parë të KNEI të mbajtur më 20 shtator 2017, u diskutua për aktivitetet e realizuara të Qeverisë dhe planet e ardhshme në pjesën e reformave të lidhura me procesin e integritetit evropian.
- **Rivendosja e rolit esencial mbikëqyrës të Komisionit për Mbikëqyrjen e Punës së Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit dhe Agjencisë së Inteligjencës, përmes takimeve të rregullta në të cilat DBK dhe Agjencia e Inteligjencës do të marrin pjesë në mënyrë aktive.**
 - Komisioni për Mbikëqyrje të Punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim mbajti mbledhje më 04.07.2017, në të cilën u miratua Rregullorja e punës.
 - Më 19.07.2017 në Kuvend u mbajt takimi i përbashkët i të dy komisioneve parlamentare për mbikëqyrje të punës së shërbimeve të sigurimit dhe zbulimit, me ekspertët e Komisionit Evropian të udhëhequr nga R. Pribe. Në takimin u bisedua për mbikëqyrjen e Kuvendit dhe për implementimin e rekomandimeve. Në takim, të pranishmit u pajtuan se bashkërisht do të punojnë për përmbushjen e rekomandimeve. Kryetarët e të dy komisioneve theksuan se do të japin kontribut më të madh në të gjitha sferat për të cilat janë kompetentë komisionet.
 - Më 30.08.2017 u mbajt mbledhja e dytë e Komisionit. Mbledhja u mbyll për opinionin për shkak të informatave të klasifikuara në dokumentet, Komisioni diskutoi për Raportin e punës së DSK-së dhe AZ-së për vitin 2016.
 - Më 18.09.2017 u mbajt mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrje të Punës së Drejtorisë për Zbulim dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim, ku u shqyrtua Informata për nevojën e formimit të Grupit punues ndër-resorcial për përgatitjen dhe ndjekjen e implementimit të Planit për realizimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të lartë për çështje sistemore nga sundimi i të drejtës në lidhje me ndjekjen e komunikimeve. Komisioni caktoi dy anëtarë që do të marrin pjesë në punën e grupit punues ndër-institucional.
- **Rivendosja e rolit thelbësor mbikëqyrës të Komisionit për Mbikëqyrje mbi zbatimin e masës së posaçme hetimore të përgjimit të komunikimeve nga Ministria e Brendshme, Policia Financiare, Drejtoria Doganore dhe Ministria e Mbrojtjes përmes takimeve të rregullta në të cilat e detyrueshme pjesëmarrja aktive e të gjitha institucioneve.**
 - Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masës së Veçantë Hetuese Ndjekje të Komunikimeve nga ana e MPBsë, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria e Doganave dhe Ministria e Mbrojtjes, më 18.07.2017 e mbajti mbledhjen e parë në të cilën u miratua Rregullorja punën e komisionit. Në mbledhje ishin të pranishëm përfaqësuesit e MPB-së, Drejtorisë së Policisë Financiare, Drejtorisë së Doganave dhe Ministrisë së Mbrojtjes
-
- **Riaktivizimi i Klubit të Përfaqësuesve të Grave**
 - Mbledhja konstituive e Klubit të grave deputete u mbajt më 6 korrik 2017. Klubi do të punojë për iniciimin e zgjidhjeve ligjore për arritje të barazisë gjinore dhe avancim të të drejtave të



femrave, përfshirje të tyre aktive në procesin e vendimmarrjes në shtet si dhe për forcimin dhe zgjerimin e demokracisë në të gjitha sferat e shoqërisë. Klubi i deputeteve më 20.07.2017 mbajti takim me temë “Klubi i deputeteve, arritjet dhe prioritetet”. Më 27.07.2017 u mbajt mbledhja e dytë.

- Klubi, në kuadër të kompetencave të tij, reagoi dhe e gjykoi sjelljen diskriminuese ndaj femrave-pjesëmarrëse në Maratonën ndërkombëtare të atletëve në Ohër, ku shpërblimet për femrat pjesëmarrëse në gara, janë më të ulëta se ato për meshkujt garues. Gjithashtu, gjatë muajit gusht punoi përpilimin e Propozim-Deklaratës për përfshirje të më shumë grave kryetare komunash në Republikën e Maqedonisë. Më 21-22 shtator, klubi mbajti punëtori me temën: “Ndërtojmë ura mirëkuptimi” ku morën pjesë anëtarë të Klubit të Deputeteve të Kuvendit.

- **Riaktivizimi i Komitetit të Përhershëm Anketues për të Drejtat e Njeriut**

- Në mbledhjen e Komisionit të Përhershëm Anketues për të Drejtat e Njeriut të mbajtur më 14.07.2017 u zgjodhën kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit me çka u kompletua përbërja.
- Kryetari i Komisionit të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit, më 14.09.2017, mbajti takim me NDI, ku u diskutua për çështjet prioritare për shqyrtim në mbledhjet e ardhshme, organizim të vizitave në terren të shtëpive ndëshkimore-korrektuese, institucioneve për sëmundje shpirtërore, Qendrës strehimore për azilkërkuesit dhe të tjera, si dhe për organizimin e shënimit të 10 dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare për Drejtat e Njeriut, në Kuvend.

- **Puna mbikëqyrëse e rregullt dhe substanciale e Komisionit për Mbikëqyrjen e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masës Speciale të Hetimeve të Ndalimit të Komunikimeve nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Mbrojtjes, përmes mbledhjeve të rregullta në të cilat institucionet kompetente do të marrin pjesë në mënyrë aktive,**

- Më 16.11.2017. në Parlament u mbajt një takim i ad hoc grupit Ndërministror për Reformën, ku morën pjesë kryetari i Kuvendit, Ministri i Punëve të Brendshme, koordinatorët e grupeve parlamentare, si dhe përfaqësues të komisioneve mbikëqyrëse parlamentare. Takimi kishte për qëllim ndarjen e informacionit mbi përgatitjet për zbatimin e reformave në shërbimet e sigurisë që dalin nga Raporti i ekspertëve të nivelit të lartë. Paketa e reformës ishte tema e debatit publik dhe për përfshirjen e Parlamentit, institucioneve kompetente, sferës akademike dhe shoqërisë civile, për të siguruar gjithëpërfshirjen dhe transparencën e procesit që ka për qëllim mbrojtjen e rendit kushtetues të vendit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut.

- **Forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masës Speciale Hetimore të përgjimit të Komunikimeve nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Mbrojtjes, përmes bashkëpunimit aktiv me Qendrën e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).**

- Kryetarët dhe anëtarët e Komisionit në Komisionin për mbrojtje dhe siguri për të kontrolluar funksionimin e DBK dhe AI dhe Komisioni për mbikëqyrjen e përgjimit të komunikimeve, si dhe drejtorët e inteligjencës dhe të sigurisë së institucioneve të Republikës së Maqedonisë, nga 21-23.11.2017 morën pjesë në një tryezë të rrumbullakët për të reformimin komunitetit të



inteligjencës dhe për të forcuar mbikëqyrjen parlamentare, mbajtur në Gjenevë, Zvicër. Veprimtaria u organizua nga Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura - DCAF, dhe u mbështet nga Qeveria e Zvicrës. Në frymën e bashkëpunimit strategjik në mes të DCAF dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë u përgatit një plan veprimi me asistencën profesionale të organeve punuese të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

- **Vazhdimi i punës së grupit punues të Kuvendit për reforma me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje të pranueshme politike për ndryshimet në Rregulloren e punës dhe forcimin e kapaciteteve të pavarura të Kuvendit,**
 - Grupi parlamentar i punës përgatiti një projekt-dokument që ndryshon Rregulloren e Punës për të forcuar kapacitetet e pavarura të Kuvendit. Drafti pret konsensusin politik që të votohet zyrtarisht.
- **Bashkëpunim aktiv me ekspertët e BE-së në Kuvend dhe përfshirjen e tyre në grupin e punës për reformën e Parlamentit**
 - Ekspertët e BE-së janë aktivisht të përfshirë në grupin reformues të Kuvendit, si dhe grupin për hartimin e Kodit të Etikës
- **Miratimi i një Kodi Etik për Anëtarët e Kuvendit, në përputhje me rekomandimet e Raportit të datës 24.12.2012. dhe GRECO-s**
 - Grupi Parlamentar i Punës ka hartuar një Kod Etik për Anëtarët e Parlamentit dhe Shërbimin, në përputhje me rekomandimet e GRECO-s. Drafti pret konsensusin politik që të votohet zyrtarisht.
- **Mbështetja aktive e Parlamentit duke ofruar kushte për funksionimin dhe demonstrimin e mbështetjes politike për punën e grupeve të interesit, shumëpartiake, të deputetëve si Klubi i deputetëve dhe Klubi i deputetëve të rinj,**
 - Nën organizimin e UN Women dhe Lobit të Grave të Maqedonisë (MWL), në Strugë më 21 dhe 22 shtator 2017 u organizua një seminar nën moton "Ndërtimi i Urave të Mirëkuptimit", në të cilin morën pjesë anëtarët e Klubit të Anëtarëve të Kuvendit. Punëtorja u drejtua nga Koordinatori i Klubit të Grave, përfaqësuesit e Barazisë Gjinore të Grave të OKB-së dhe Fuqizimit të Grave (Gratë e OKB-së), Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe Drejtori Ekzekutiv i Lobit të Grave të Maqedonisë.
 - Klubi i deputetëve më 6 tetor 2017. në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI), organizoi promovimin e kandidatëve për zgjedhjet për kryetarë komunash në Republikën e Maqedonisë. Nga 15 kandidatë për promovim të kryetarëve të komunave, u paraqitën 10 kandidatë. Në zgjedhjet lokale në listat e këshillit ishin 15 kandidatë për kryetarë komunash dhe 50 mbështetës. Ekziston nevoja për rritjen e numrit të grave në strukturat vendimmarrëse në jetën politike dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë.
- **Pjesëmarrja proaktive e grupeve parlamentare në iniciativat ndërkombëtare dhe fillimi i iniciativave të pavarura parlamentare që kanë për qëllim përmirësimin e besimit dhe promovimit të dialogut ndërmjet shumicës dhe opozitës,**
 - Kuvendi në një përbërje gjithëpërfshirëse mori pjesë në iniciativën Park Wilton në Mbretërinë e Bashkuar, e cila u realizua në periudhën 14-16.02.2018.



ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

RAPORTI FAKTOGRAFIK PËR IMPLEMENTIMIN E:

PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





4. Emërime

Qeveria obligohet që t'i respektojë në tërësi procedurat ligjore dhe kriteret për emërimin e personave në pozita udhëheqëse, si dhe të anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrëse. Gjithashtu, Qeveria do të përpiqet që edhe më tutje të sigurojë funksionim të papenguar të të gjitha institucioneve shtetërore duke përfshirë edhe rrjetin diplomatik, duke respektuar në tërësi kompetencat e definuara kushtetuese dhe ligjore.

- **Vazdimi i konsultimeve me Kryetarin e RM-së për plotësimin e vendeve të zbrazëta dhe përfaqësitë diplomatiko - konsullore**
 - Po realizohen konsultime me kryetarin e Republikës së Maqedonisë për plotësimin e vendeve vakante në përfaqësitë diplomatike.
 - Është mbyllur procedura formale për emërimin e grupit të parë prej 8 ambasadorësh - shefa të PDK. Procedura e akreditimit për 7 ambasadorë - shefa të PDK ka përfunduar, ndërkaq për ambasadorin e 8 është në vijim e sipër. Konsultimet do të vazhdojnë për grupin vijues të propozimeve initiale të shefave të PDK
- **Zgjedhja e Prokurorit Publik**
 - Qeveria më 07.11.2017 i dërgoi Kuvendit Propozimin për emërimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë. Prokurori Publik është zgjedhur më 25.12.2017
- **Zgjedhja e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese**
 - Kryetari i Republikës së Maqedonisë më 20.11.2017 i dërgoi Kuvendit Propozimin për zgjedhjen e dy gjykatësve të Gjykatës Kushtetues.
 - Janë zgjedhur tre gjykatës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, dy prej të cilëve më 11.01.2018 të propozuar nga Kryetari dhe një gjykatës me 05.03.2018 i propozuar nga Kuvendi.
- **Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publik**
 - Nga kryetari i Kuvendit të RM u publikuan dy shpallje për zgjedhje të dy anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publik, edhe atë i pari me 07.06.2017 ndërsa i dyti më 18.08.2017.
 - Është zgjedhur një anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publik në shkurt të vitit 2018, dhe dy anëtarë të rinj më 05.03.2018.
- **Zgjedhja e gjykatësve për vendet e zbrazëta**
 - Në periudhën prej shtatorit 2017 deri më tani KGJRM bëri zgjedhjen e pesë gjykatësve dhe të pesë kryetarëve të gjykatave:
 - Më 08.11.2017 u zgjodh kryetari i GJTH-së Shkupi 1, në pajtim me shpalljen e publikuar me 24.07.2017
 - Me 23.11.2017 janë zgjedhur katër kryetarë të gjykatave (Kryetari i GJA Shtip, kryetari i GJTH Kumanovë, kryetari i GJTH Tetovë dhe kryetari i GJTH Resnjë), në pajtim me shpalljen e publikuar më 24.07.2017
 - Më 23.11.2017 janë zgjedhur pesë gjykatës: një gjykatës në Gjykatën Supreme, tre gjykatës në Gjykatën e Apelit të Shkupit, dhe një gjykatës në Gjykatën e Apelit të Manastirit.
 - Me 25.12.2017 është publikuar shpallja për zgjedhjen e dy kryetarëve të gjykatave dhe dy gjykatësve: kryetari i Gjykatës së Apelit Shkup dhe kryetari i Gjykatës Themelore Dibër, si dhe një gjykatës (për fushën penale) në Gjyqin Suprem të Republikës së Maqedonisë dhe një gjykatës (për fushën penale) në Gjykatën e Apelit Shkup. Në shpallje janë paraqitur gjithsej 14



PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018

kandidatë për kryetar dhe 27 kandidat për gjykatës. Procedura për zgjedhje është në vijim e sipër.

- Më 14.03.2018 është marrë vendimi me të cilin është përcaktuar një gjykatës në Gjykatën e Apelit Shkup për ushtrues detyre të kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkup.



PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





5. Reforma e administratës publike (RAP) dhe qeverisje e mirë

Reforma e administratës publike (RAP) është një prej prioriteteve themelore të Qeverisë, e cila filloi me përgatitjen e Strategjisë, cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të realizueshme për RAP. Qëllimet kryesore të RAP janë departizimi dhe profesionalizimi i administratës si dhe ndërtimi i një administrate transparente cilësore dhe të orientuar për shërbime, e cila do të funksionojë dhe do të punojë në kushte të përmirësuara.

Me përforsimin e **interoperabilitetit**, shtimin e numrit të e-shërbimeve dhe zbatimin e teknologjive bashkëkohore informatike, Qeveria synon digjitalizimin për sigurim të shërbimeve më të shpejta, më të thjeshta e më të lehta për qytetarët.

Në pjesën e **qeverisjes së mirë**, Qeveria publikoi Buxhetin qytetar për Buxhetin e vitit 2018, me qëllim që qytetarët të fitojnë një pasqyrë të kuptueshme për shpenzimet e financave publike. Gjithashtu, Qeveria miratoi Programin për reforma të qeverisjes me financat publike 2018-2021, e cila duhet të sigurojë stabilitet dhe forcim të planifikimit afatmesëm.

- **Qeveria do të marrë Vendim për deklasifikimin e të gjitha dokumenteve me interes për publikun**
 - Qeveria miratoi në mbledhjen e 8, të mbajtur më 22.06.2017, konkluzionin përmes të cilit obligoi të gjitha ministritë që t'i deklasifikojnë të gjitha informatat - të dhënat që ndërlidhen me shpenzimet për udhëtime zyrtare dhe shpenzimet për reprezentacion në vetë ministritë (në të ardhmen, si dhe në periudhën paraprake), përveç të dhënave që duhet të mbeten të mbrojtura në pajtim me dispozitat ligjore (për struktura sigurie, shërbime e të ngjashme).
 - Qeveria në mbledhjen e 25 të mbajtur më 29.08.2017 mori vendim që të deklasifikohen informatat e përpiluara nga Qeveria të cilat janë me interes publik dhe që kanë të bëjnë me kontratat për ndarje të ndihmës shtetërore.
 - Në këtë kontekst u obliguan Agjencia për investime të huaja dhe Drejtoria për zonat e zhvillimit teknologjik industrial për të deklasifikuar informacionet të cilat më parë ishin të klasifikuara nga institucionet e tyre, e të cilat kanë të bëjnë me informacionet dhe kontratat për ndarje të ndihmës shtetërore.
- **Anulimi i vendimit për verifikimin e kompensimit për ndihma materiale për informacionin e dhënë, nga mbajtësit e informacioneve.**
 - Më 17.08.2017 Zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, mbajti takim me Komisionin për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik, me ç'rast u diskutua për mundësitë dhe efektet nga shfuqizimi eventual i Vendimit për verifikimin e kompensimit për shpenzime materiale për informacionin e dhënë nga bartësit e informacioneve.
 - Në mbledhjen e 28 të QRM të mbajtur më 19.09.2017 u mor vendim me të cilin u shfuqizua kompensimi për dhënien e informacionit me karakter publik, në formë të të dhënave elektronike në USB ose në e-mail adresën e kërkuarëve.
- **Revidimi i regjistrit të bartësve të informacioneve të karakterit publik dhe të personave kompetentë për qasje të lirë deri tek informacioni me karakter publik në të gjitha institucionet dhe obligimi i institucioneve që t'i shpallin në web faqet dokumentet e karakterit publik.**
 - Regjistri (Lista) e bartësve përditësohet rregullisht. Më 24 gusht 2017 u dërgua letër qarkore për azhurnimin e të dhënave, me qëllim që përgjegjësit dhe personat zyrtarë të evidentuar në Regjistrin e bartësve të informacioneve me karakter publik, të publikuara në web lokacionin e



komisionit, të përkujtohen për obligimin i cili del nga nenet 8 dhe 9 të Ligjit për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik. E njëjta u dërgua edhe në mënyrë elektronike edhe tek 1259 persona të Listës së bartësve për vitin 2016. Komisioni deri më 14.12.2017 regjistroi dhe evidentoi ndryshime të bëra tek bartësit e informacioneve me çka u bënë ndryshime dhe korrigjime tek gjithsej 836 bartës dhe u azhuruan edhe të dhënat e 137 personave të rinj të emëruar.

- **Publikimi i rendeve të ditës të mbledhjeve të Qeverisë në web faqe**

- Në pajtim me angazhimet dhe transparencën e shprehur për punën e Qeverisë, në web faqen e Qeverisë është krijuar një seksion i ri "Seanca të Qeverisë" <http://vlada.mk/vladini-sednici> me të cilin mundësohet qasje deri tek rendet e ditës dhe procesverbalet e miratuara nga mbledhjet e Qeverisë (konkluzat e sjella lidhur me pikat e rendit të ditës). Kjo risi më 17.08.2017 u shpall dhe u promovua zyrtarisht në media.

- **Miratimi i Strategjisë për reformë të administratës publike 2018-2022 me Plan aksional**

- Nëngrupet e punës për përpunimin e Strategjisë së RAP dhe të Planit Aksional rregullisht mbanin mbledhje. Gjatë muajit tetor 2017, koordinorët e grupeve punuese bashkëvepruan me ekspertët e SIGMA-s për revidimin e Planit aksional dhe të shpenzimeve të Strategjisë të cilat njëherësh u shqyrtuan në takimet e anëtarëve të nëngrupeve punuese.
- Më 17.11.2017 Draft-Strategjia e RAP u dërgua për mendim dhe komentim në KE, ndërsa në mënyrë plotësuese me 13.12.2017 është dërguar edhe draft testi final i strategjisë, ndërkaq draft Plani aksional iu dërgua KE-së më 26.12.2017.
- Draft dokumentet u vendosën në web faqen e MShIA (<http://www.mioa.gov.mk/?q=node/4542>)
- Më 15.01.2018 u mbajt debat publik në të cilin u prezantuan versionet e fundit të Draft strategjisë së RAP (2018-2022) dhe Planit Aksional.
- Më 30.01.2018 janë marrë komentet e SIGMA-s, më 06.02.2018 janë marrë zyrtarisht edhe komentet e Këshillit të Evropës dhe të njëjtat janë integruar.
- Strategjia për reformë të administratës publike 2018-2022, me Planin aksional është miratuar në qeveri me 22.02.2018.
- Në fokus është krijimi i administratës profesionale, efikase, llogaridhënëse dhe transparente e cila do të sigurojë shërbime cilësore për qytetarët dhe sektorin e biznesit dhe do të mbrojë të drejtat e tyre. Strategjia për reformë të administratës publike parasheh reforma në katër fusha prioritare: (1) krijimi i politikave dhe koordinimi, (2) shërbimi publik dhe menaxhimi me resurse njerëzore, (3) përgjegjësia, llogaridhënia dhe transparenca dhe (4) shërbimet publike dhe mbështetje IKT të administratës. Menaxhimi me financat publike është rregulluar me dokument të veçantë strategjik.

- **Formimi i Këshillit për reforma të administratës publike i kryesuar nga KQRM, i obliguar për koordinimin e procesit të RAP**

- Në një seancë të Qeverisë të mbajtur më 20 dhjetor 2018, mor vendim për formimin e Këshillit për Reformë të Administratës Publike. Kryeministri është kryetar i Këshillit dhe anëtarë janë Zëvendës Kryeministri për Çështje Evropiane, Zëvendës Kryeministri për Marrëveshjen Kornizë dhe për Sistem Politik, Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë, Ministri për Punë dhe Politikë Sociale, Ministri i Pushtetit Lokal, Ministri pa portofol përgjegjës për komunikim, llogaridhënie dhe transparencë, Sekretari i



Përgjithshëm i Qeverisë, Drejtori i Agjencisë për administratë, Kryetari i Asociacionit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe Sekretari i Sekretariatit për Legjislacion.

- Seanca konstitutive e Këshillit u mbajt më 21.12.2017, në të cilën u dakordua mënyra e punës së Këshillit lidhur me monitorimin e realizimit të kësaj reforme të rëndësishme, sipas udhëzimeve të KE.
 - Është themeluar Sekretariati i Këshillit, i cili mbajti takimin e parë më 19.02.2018.
 - Më 20 shkurt 2018, u mbajt takimi i parë i Këshillit, i cili miratoi tekstin e Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2018-2022 dhe planit aksional para miratimit të tij përfundimtar nga Qeveria.
- ***Përforcimi i kapaciteteve të brendshme të MSHIA për monitorim të implementimit të aktiviteteve të strategjisë - formim i ekipit të përbërë nga nëpunës administrativ të MSHIA***
 - Me Vendim u krijua Ekipi për reformë të administratës publike. Ekipi përbëhet nga 34 zyrtarë të ministrisë. Ekipi i reformës së administratës publike është i obliguar për (1) monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Reformë të Administratës Publike 2018-2022; (2) konsultimin e detyrueshëm dhe harmonizimin e prioriteteve dhe objektivave të Strategjisë së RAP 2018 - 2022 me Vendimin me të cilin Qeveria çdo vit përcakton përparësitë strategjike dhe qëllimet e veta prioritare; (3) bërjen e vlerësimeve të ndikimit të prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që kanë të bëjnë me RAP; (4) mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e raporteve për progresin e bërë që i dedikohen Sekretariatit të RAP, Këshillit të RAP dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë; (5) realizimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të projekteve mbështetëse të RAP-it të financuara nga bashkësia ndërkombëtare dhe donatorët; (6) sigurim të komunikimit të rregullt me personat e kontaktit të institucioneve relevante dhe (7) realizim të bashkëpunimit me të gjithë pjesëmarrësit në procesin e RAP. Secili anëtar i ekipit do të ketë detyra konkrete, në përputhje me planin operativ për zbatimin e Planit Aksional.
 - ***Miratimi i kahjeve për qeverisje të mirë të personave të zgjedhur dhe të emëruar në pushtetin ekzekutiv***
 - Është përgatitur analizë krahasuese e Dokumentit (nga Komisioni Evropian, Britania e Madhe, Kanadaja dhe SHBA) për sjellje të mirë (Code of conducte) të personave të zgjedhur dhe të emëruar si bazë për përgatitjen e Kahjeve.
 - Është përgatitur draft teksti i Kahjeve i cili duhet të finalizohet deri nga mesi i shkurtit. Më 23.02.2018 u mbajt takimi me organizatat civile me të cilat u diskutua teksti. Janë marr komente dhe vërejtje nga shoqatat civile të cilat janë inkuadruar në draft Kahjet. Më 26.03.2018, u mbajt takim me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore. Kahjet u miratuan nga Qeveria më 27.03.2018 dhe të njëjtat ju dërguan të gjithë personave të zgjedhur dhe të emëruar.
 - ***Përgatitja e analizës së kornizës ligjore për organet e administratës shtetërore, agjencive dhe shërbimeve të inspektionit si bazë për analizë horizontale funksionale***
 - Më 19.12.2017 u nënshkrua Memorandum për bashkëpunim midis UNDP dhe Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, për fillimin e projektit në suaza të të cilit do të realizohet kjo analizë, dhe është shpallur thirrja për ekspertë për përgatitjes së të njëjtës. Në kuadër të këtij projekti do të përgatitet harta dhe grupimi i institucioneve në Republikën e Maqedonisë, e cila të njëjtat do ti grupojë sipas statusit, llojit dhe informacioneve të tjera relevante të tyre (prej kujt formohen, para kujt përgjigjen për punën etj). Të dhënat dhe informacionet nga hartat do të shkrihen në katalog të institucioneve. Në bazë të katalogut, do të bëhet analiza e kornizës



- ligjore për organet e administratës shtetërore, agjencitë dhe shërbimet e inspektionit me të cilin do të shqyrtohen problemet kyçe siç janë formimi i institucioneve me ligje të veçanta, vijat e llogaridhënies, kompetencat e institucioneve dhe përputhshmëria e të njëjtave, etj.
- ekspertët kishin takime bilaterale me përfaqësuesit e disa institucioneve si pikë nisjeje për analizë të kornizës ligjore të OASH dhe agjencive. Njëherësh ata mbajnë takime të rregullta me përfaqësuesit e Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë. Ekspertët përgatitën gjetje fillestare dhe konkluzione të draft raportit për kornizën e institucioneve të sektorit publik, hierarkinë në administratën publike, kufizimet funksionale dhe gjendjen e resurseve njerëzore.
 - Është përgatitur analizë për funksionimin e shërbimeve të inspektoratit.
- **Miratimi i Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Administrativ**
 - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zyrtarët Administrativ u miratua nga Qeveria më 7 nëntor 2017. dhe aprovua në Kuvend më 15.01.2018
 - Ndryshimet në Ligjin për Zyrtarët Administrativ kanë për qëllim përmirësimin e modelit të menaxhimit të burimeve njerëzore, bazuar në kompetencat, për të tërhequr dhe mbajtur punëtorët cilësorë në administratën publike, me çka do të përmirësohet cilësia e shërbimeve për qytetarët dhe komunitet të biznesit.
 - Ndryshimet do të mundësojnë kushte më të mira për avancimin e karrierës të nëpunësve civilë, të cilët për disa vite nuk kanë pasur mundësi të avancohen, megjithëse posedojnë kompetenca, aftësi dhe përvojën e punës për një pozitë të caktuar. Me ligji rristrukturohet procedura për selektimin e kandidatëve për nëpunës administrativ, kështu që në vend të katër etapave, e njëjta përbëhet nga tri, edhe atë: selektimi administrativ, provimi për nëpunësin administrativ dhe kontrollimi i besueshmërisë së dëshmimeve dhe intervistës. Lidhur me avancimin e nëpunësve administrativ, krahas avancimit në një nivel më të lartë të drejtpërdrejtë, mundësohet edhe avancimi në tre etapa, por në kuadër të kategorisë së njëjtë në të cilin është edhe vendi i punës ku është publikuar shpallja interne. Në anën tjetër, vendimet e përfshira në këtë ligj do të eliminojnë shpenzimet financiare të kandidatëve për marrjen e certifikatave të njohura ndërkombëtarisht, për njohje të njëjës prej tri gjuhëve më së shpeshti të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe njohjen e punës me programet kompjuterike për punë në zyrë.
 - Duke pasur parasysh kohën e nevojshme për përgatitjen e provimit, por edhe kohën e cila do tu nevojitet atyre që janë të obliguar për të dhënë provimin, procedura e selektimit e verifikuar në këtë ligj, në tërësi mund të fillojë të zbatohet nga një shtator 2018.
 - **Finalizimi i azhurnimit të regjistrit të të punësuarëve në sektorin publik me qëllim që të publikohet numri i përgjithshëm i të punësuarve sipas sektorëve.**
 - Azhurnimi i sistemit të informatikës për menaxhim me resurset njerëzore (HRMIS) po zhvillohet rregullisht, nga ana e institucioneve të cilat vendosin të dhëna në të njëjtin.
 - Që të sigurohet plotësim i tërësishëm i të dhënave në sistemin HRMIS, me çka do të fitohet numri i saktë i të punësuarve në sektorin publik, në mbledhjen e 34 të Kuvendit të mbajtur më 21.02.2018, u miratuan ndryshimet dhe plotësimet e katër ligjeve, edhe atë: (1) Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punësim në sektorin publik; (2) Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën tatimore; (3) Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Drejtorisë për të hyra publike; (4) Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social. Ndryshimet e propozuara të ligjeve të përmendura do të mundësojnë mbajtje më efektive të Regjistrit dhe shfrytëzim të plotë dhe funksionalitet të HRMIS.
 - Më 30.03.2018 u publikua raporti vjetor për të punësuarit në sektorin publik për vitin 2017. Në bazë të tij, numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin publik është 128,722. Raporti është i publikuar në web faqen e Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë



http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/lzvestajReg2017_v1.02.pdf .

- **Avancimi i procesit të planifikimit strategjik afatmesëm dhe përgatitja e programeve vjetore për punë përmes revidimit të Metodologjisë për planifikim strategjik dhe përgatitje të programit vjetor për punë të Qeverisë**
 - Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit "Modernizimi dhe transformimi i administratës publike".
 - Një ekip me përfaqësues të Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë, Sekretariatit të Përgjithshëm dhe Qendrës për menaxhim të ndryshimeve si implementues të projektit, punoi për ndryshimin dhe plotësimin e Metodologjisë si dhe në Udhëzimin për mënyrën, përmbajtjen dhe formën e përgatitjes së planeve strategjike të ministrive dhe të organeve të tjera të administratës shtetërore (me formularë) dhe Udhëzimin për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përcjelljes, vlerësimit dhe të njoftimit lidhur me realizimin e planit strategjik (me formular).
 - Metodologjia dhe udhëzimet janë miratuar nga Qeveria më 27.03.2018
- **Përgatitja e Strategjisë për të dhëna të hapura**
 - Ky aktivitet po realizohet në kuadër të projektit "Modernizimi dhe transformimi i administratës publike". Strategjia për të dhëna të hapura është pjesë e komponentit projektues Qeveri e hapur që parashikon modernizimin e portalit ekzistues për të dhëna të hapura, në platformë të re, përgatitje të Strategjisë nacionale për të dhëna të hapura dhe katalogjizim të aseteve të të dhënave të hapura në katër ministri (Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale dhe Ministria për Arsim dhe Shkencë).
 - Në kuadër të realizimit të projektit, janë vizituar gjashtë ministri, në të cilat është realizuar regjistrimi dhe krijimi i hartave të data bazave, si fazë fillestare e procesit të standardizimit të të dhënave.
 - Më 25.12.2017, u mbajtë një punëtori e Grupit punues (në të cilin bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të sektorit civil dhe privat si dhe të komunitetit akademik) për hartimin e Strategjisë nacionale për të dhëna të hapura. Qëllimi i punëtorisë ishte përmirësimi i transparencës dhe i llogaridhënies së institucioneve shtetërore, përmes përmirësimit të politikave të të dhënave të hapura dhe me këtë rast u definua vizioni, misioni, qëllimi dhe struktura e Strategjisë.
 - Më 01.02.2018 u mbajt punëtorja e dytë për përgatitje të Strategjisë në të cilën u shqyrtua projekti i Strategjisë. Projekti u revidua në pajtim me komentet e dhëna nga grupi punues dhe ekspertët. Ai u punua në gjuhën angleze dhe tani po punohet në finalizimin e tekstit edhe në maqedonisht.
- **Analizë e procesit të vlerësimit dhe ndikimit të rregulativës në ministritë**
 - Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 04.07.2017 i obligoi të gjitha ministritë që t'i respektojnë të gjitha procedurat për Vlerësim të Ndikimit të Rregulativës (VNR) dhe të publikojnë RUNE-në. Sipas Rregullores për punë të Qeverisë dhe sistemit e-qeveria, në mbledhje të trupave punues dhe të qeverisë po shqyrtohen materialet që i përmbajnë mendimet e nevojshme në pajtim me nenin 68 të Rregullores, duke inkorporuar edhe mendimet e Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë për propozimet e ligjeve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit të rregulativës (VNR)
 - U përgatit Projekt-Pyetësori për përmirësimin e cilësisë së vlerësimit të ndikimit të rregulativës (VNR) dhe i konsultuar me koordinatorët për VNR në ministritë dhe zëvendësit e tyre në takimin e punës të mbajtur më 20.12.2017.
 - Pyetësori elektronik iu dërgua të gjitha ministrive. Pyetësorët janë përpunuar, ndërkaq për plotësimin e analizës janë realizuar katër debate të fokusuara (08-09.02.2018).



- Analiza e procesit të vlerësimit të ndikimit të regulativës është përgatitur.
- Në mënyrë plotësuese, janë realizuar dy trajnime: për nëpunësit e kabineteve të ministrive, dhe për VNR koordinatorë dhe zëvendës.
- **Miratimi i Ligjit për Regjistrin Qendror Elektronik të popullsisë dhe të Ligjit për shërbime elektronike**
 - Më 27.10.2017 është formuar grup punues ndër-resorial. Janë përgatitur versione punuese të teksteve të ligjeve dhe aktualisht po shqyrtohen në kuadër të grupit punues dhe të institucioneve relevante. Për shkak të kompleksitetit të ligjeve dhe të konsultimit më të gjerë nevojitet kohë plotësuese për realizimin e kësaj mase.
- **Miratimi i Ligjit për mbikëqyrje të inspektoratit dhe të Ligjit për Inspektionin administrativ**
 - Më 27.10.2017 u formua grup ndër-resorial. Janë përgatitur versionet punuese të teksteve të ligjeve dhe tani po shqyrtohen në kuadër të grupeve punuese. Për shkak të kompleksitetit të ligjeve dhe konsultimit më të gjerë, nevojitet kohë plotësuese për realizimin e kësaj mase.
- **Miratimi i Programit për reforma në menaxhim të financave publike 2018 - 2021**
 - Draft teksti i ri i Programit për menaxhim me financat publike 2018-2021 u finalizua dhe ju dërgua Delegacionit të BE-së më 19 korrik 2017. Dialogu publik me palët e interesuara (sektorin civil, akademinë, shoqatat) u realizuan më 19.09.2017. Pas konsultimit të mbajtur dhe pas komenteve të marra, pasoi revidimi i tekstit të programit.
 - Më 19.12.2017 Qeveria miratoi Programin për reformë të menaxhimit me financat publike 2018-2021. Para se të miratohej, Programi ishte në dispozicion për shqyrtim dhe komente të publikut deri më 1 shtator 2017 (<http://www.finance.gov.mk/mk/node/6626>).
 - Programi për reforma të menaxhimit me financa publike është përgatitur me qëllim që të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i konsumit publik, disiplina fiskale, qëndrueshmëria e borxhit dhe menaxhimi efikas transparent dhe bashkëkohor me financat publike. I njëjti është publikuar në web faqen e Ministrisë së Financave dhe është në dispozicion në këtë link: http://finance.gov.mk/files/u3/PFM%20Reform%20%20Programme__MK%20DEC%202017_final%20VLADA.pdf.
 - Më 12.02.2018 u formua Këshilli për menaxhim me financat publike, i kryesuar nga Ministri i Financave, ndërkaq anëtarë janë Zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, Zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Ekonomike, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Drejtori i Drejtorisë së Doganave, Drejtori i Drejtorisë për të Hyra Publike, Drejtori i Byrosë për Furnizime Publike, Drejtori i Entit Shtetëror të Statistikës, Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ankesa lidhur me Furnizimet Publike dhe Revizori Shtetëror.
 - Më 19.02.2018 është mbajtur mbledhja e parë në të cilën u miratua lista e koordinatorëve të emëruar të prioritetëve dhe liderëve të masave të Programit për reforma të menaxhimit të financave publike, dhe u shqyrtua dhe aprovua Draft Plani aksional për realizimin e Programit për reforma të menaxhimit me financat publike për vitin 2018.
 - Më 20.02.2018 në mbledhje të Qeverisë u miratua Informacioni i mbledhjes së parë të Këshillit për menaxhim me financat publike e mbajtur me 19.02.2018 me Propozim-planin e veprimit për realizimin e Programit për reforma të menaxhimit me financat publike për vitin 2018.
- **Publikimi i Buxhetit qytetar për vitin 2018**
 - Më 16.11.2017, Buxheti qytetar u publikua në web faqen e Ministrisë së Financave, ju dërgua përfaqësuesve të mediave - gazetarëve dhe u shpërnda në rrjetet sociale të profileve të Ministrisë së Financave dhe të Agjencisë së jajeve MIA. Kopje ju dërguan edhe deputetëve të Kuvendit - anëtarëve të Komisionit për Financa dhe Buxhet, si dhe Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Parlamentit. I njëjti është në dispozicion në:



<http://www.finance.gov.mk/mk/node/6808> për publikun e gjerë.

- **Fillimi i konsultimeve publike mbi reformën e prokurimeve publike dhe pranimi i sugjerimeve të SIGMA-s në lidhje me sistemin e prokurimit publik dhe Këshillit**
 - Më 03.11.2017 u organizua debat me temën "Reforma në sistemin e prokurimit publik", ku morën pjesë përfaqësues të sektorit civil, nga Delegacioni i BE-së dhe SIGMA, ku u diskutuan reformat që do të zbatohen në sistemin e prokurimit publik, ndërkaq u paralajmërua një ligj i ri si dhe thjeshtësimi i procedurave.
 - Më 03.11.2017 Qeveria miratoi Propozim-Ligjin për ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik, i cili u miratua nga Kuvendi më 9 nëntor 2017, me procedurë të shkurtuar me çka u anulua Këshilli i Prokurimit Publik
 - Procedura e RUNE për ligjin e ri të prokurimit publik që i adreson vërejtjet e SIGMA-s, të opinionit të ekspertëve, të shfrytëzuesve të buxhetit dhe të palëve të tjera të prekura, ka filluar më 31 janar 2018. Propozim Ligji ishte në diskutim publik përmes RUNE më 06.02.2018. Gjithashtu, prezantimi publik i ndryshimeve të ligjit u bë më 13.02.2018 në Shkup, para komunitetit të biznesit (linku: <http://www.finance.gov.mk/mk/node/7051>), më 22.02.2018 në Strugë (linku: <https://www.finance.gov.mk/mk/node/7064>), si dhe më 02.03.2018 në Shtip (linku: <https://www.finance.gov.mk/mk/node/7093>), duke inkorporuar edhe konsultimet me KE.
- **Përgatitja e Dokumentit për politika të reformave në kontrollin publik të brendshëm financiar**
 - Për këtë dokument strategjik u formua grup pune në bashkëpunim me SIGMA. Grupi punues, pas një numri takimesh dhe angazhimit intensiv arriti që ta rumbullakësojë Dokumentin e përgatitur për politika të reformave në kontrollin publik të brendshëm financiar - "Politika e kontrollit të brendshëm publik financiar në periudhën 2018-2020".
 - Më 13.02.2018, ekspertë të SIGMA-s mbajtën prezantim para anëtarëve të Qeverisë lidhur me rëndësinë e kontrollit të brendshëm financiar dhe llogaridhënien. Në prezantim një vëmendje e veçantë iu kushtua monitorimit të llogaridhënies në institucionet qeveritare, me konstatim se në gjysmën e dytë të vitit 2017 është bërë hap përpara në menaxhim me institucionet dhe kontrollin e brendshëm, me ç'rast u shprehën vlerësime për harmonizimin e politikave dhe strategjive në financa. Raporti i monitorimit të SIGMA-s shpjegon se hapi përpara në gjysmën e dytë të vitit 2017 ka të bëjë me përgatitjen e dy dokumenteve strategjike " Programin për reforma në menaxhimin me financa publike 2018-2021" dhe "Strategjia për reforma në administratën publike 2017-2022".
 - Më 30.03.2018, versioni final i Dokumentit strategjik për politika të reformave në kontrollin e brendshëm publik financiar i është dërguar KE-së për mendim. Pas komenteve të marra nga KE, Dokumenti duhet të hyjë në procedurë qeveritare.
- **Përgatitja e versionit punues të propozim ndryshimeve të Ligjit për Buxhete.**
 - Në fund të vitit 2017 u përgatit versioni punues i propozim ndryshimeve të Ligjit për Buxhete. Me Ligjin e ri për Buxhete do të përforcohet buxhetimi afatmesëm dhe do të parashtrohen reforma të procesit buxhetor përmes zhvendosjes së kornizës kohore në gjysmën e parë të vitit, do të aplikohen rregullat fiskale, dhe gjithë kjo me qëllim që të arrihet: transparencë më e madhe dhe përcjellje e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore sipas projekteve reale afatmesme, procedura më të qarta dhe përgjegjësi në procesin e gjithmbarshëm dhe parashikueshmëri e buxhetit.



PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





6. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Qeveria vlerëson se lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do të jetë efikase përdërisa hetimet inician dhe zhvillohen në mënyrë ligjore sipas parimeve të objektivitetit dhe pa-anshmërisë. Së këtejmi **prioritet themelor është përforsimi dhe përparimi i mekanizmave për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit**, dhe çlirimit të tyre nga ndikimet dhe presioni politik. Në këtë proces, tërësisht do të merren parasysh rekomandimet e ekspertëve të vendit dhe të jashtëm, si dhe të shoqërisë civile.

- **Qeveria i bën thirrje Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit të përgatisë Raport të detajuar analitik për të gjitha procedurat e ngritura dhe hetimet për korrupsion për 5 vitet e fundit, sipas formatit të EK**
 - Raporti i dërguar i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit do të merret parasysh gjatë definimit të masave të mëtejshme për përforsimin e saj.
 - Nga 7 anëtarët e KSHPK, 5 kanë dhënë dorëheqje si rezultat i informacionit publik për shfrytëzim të padrejtë të mjeteve buxhetore.
- **Vendosja e standardeve minimale për mbrojtje fizike, administrative, informatike dhe teknike në Njësinë për Eliminimin e Krimit të Organizuar dhe Serioz (NJEKOS)**
 - Në MPB ekzistojnë minimum standarde për mbrojtje fizike, administrative, informatike dhe teknike, me çka selia e MPB paraqet zonë të veçantë sigurie me masa të veçanta për mbrojtje fizike, administrative, informatike e teknike siç janë, sigurimi fizik, pengesat mbrojtëse dhe rrethojat, video monitorimi për siguri etj. Gjithashtu janë vendosur pika të kontrollit për qasje respektivisht hyrje në objektet e çarkut të MPB. Lidhur me sigurinë administrative për shfrytëzuesit e informatave të klasifikuara mbahet evidencë e veçantë për dhënien e certifikatave të sigurisë.
 - Krahas asaj që tani më janë të vendosura minimum standarde, janë marr masa, aktivitete dhe iniciativa plotësuese, me qëllim që të ngitet niveli i standardeve përmes të cilave NJEKOS do të merrte trajtimin e zonës së veçantë të sigurisë. Përmes realizimit të tërësishëm të aktivitetit do të përmirësohej edhe siguria fizike, teknike dhe administrative e objektit në të cilin është e vendosur NJEKOS në qarkun e MPB, si dhe njësitve të tjera organizative siç është Qendra koordinative nacionale për eliminimin e krimit të organizuar dhe serioz, i cili është i vendosur në të njëjtin objekt. Implementimi i tërësishëm i aktivitetit do të thotë rritje plotësuese e sigurisë, dhe e integritetit të informacioneve të cilat tubohen, përpunohen, përgatiten, analizohen dhe shpërndahen me organet kompetente dhe institucionet, si një prej parakushteve për forcimin e besimit tek institucionet partnere ndërkombëtare, me qëllim të bashkëpunimit të suksesshëm ndërkombëtar në luftë kundër krimit të organizuar.
 - Përveç kësaj në Plan është bërë specifikimi teknik i dy segmenteve, 1. mjete teknike në pjesën e sistemit të monitorimit dhe qasja fizike në objekt dhe 2. punët ndërtimore të cilat do të sigurojnë shkallë më të lartë të integritetit.
 - Është përgatitur specifikacioni financiar dhe është konstatuar se një pjesë e mjeteve janë



siguruar nga buxheti i MPB.

- Më 11 prill 2018 do të mbahet takimi i donatorëve me përfaqësuesit e ambasadave në të cilin do të prezantohen Plani për përforsim kadrovik të NjEKOS dhe nevojave dhe për pajisjen materiale teknike.

- **Përgatitja e planit për përforsim kadrovik të Njesisë për eliminimin e krimit të organizuar dhe serioz (NjEKOS)**

- Plani për përforsim kadrovik të Njesisë për eliminimin e krimit të organizuar dhe serioz është përgatitur. Gjatë përgatitjes së planit, janë marr parasysh rekomandimet e raporteve të misioneve vlerësuese dhe të grupeve të ekspertëve të cilat në periudhën e kaluar bënë evaluimin e Kapitullit 24 - Drejtësi, liri dhe siguri, e në veçanti rekomandimet e misionit vlerësues të komisionit vlerësues të BE-së, si dhe rekomandimet të përmbajtura në raportet e ekspertëve të lartë në fushën e sundimit të ligjit.

- Plani paraqet dokument kompleks i cili parasheh dhe jep orientime për integrim të mëtejshëm institucional dhe forcim të NjEKOS, për ngritjen e nivelit të standardit minimal për mbrojtje fizike, administrative, informatike dhe teknike të NjEKOS. Përmes planit definohej tri platforma nëpërmjet të cilave do të duhet të përgatiten dhe të implementohen dokumentet dhe metodologji të veçanta strategjike siç janë:

- **Ri-definimi i mbarështrimit dhe kompetencave organizative**

Jepet analizë e shkurtër komparative lidhur me kompetencat ligjore të NjEKOS me njësi organizative të MPB, BSP, për kompetencat, ndërlikueshmërinë e detyrave të punës, numrit të punësuarve, si dhe ajo që në NjEKOS janë të koncentruar resurse që i shfrytëzojnë edhe njësi të tjera organizative në BSP, Prokurorit Publike dhe institucionet tjera dhe të përgatitet nomenklaturë konkrete (listë) për vepra penale për të çka kompetente është NjEKOS.

- **Metodologjia për prioritizimin e lëndëve dhe zhvillimi i hetimeve kriminalistike**

Verifikohet nevoja e revidimit të metodologjisë ekzistuese për zhvillimin e hetimeve kriminalistike duke marr parasysh nevojën që të zvogëlohet hapësira për subjektivitet në vendosje, në drejtim të harmonizimit me standardet e BE-së për aplikim të konceptit për operacion kriminalistik të inteligjencës dhe hulumtim kriminalistik, si pjesë e procedurës parapenale, me çka në mënyrë më të qartë do të implementohet koncepti në baza të dyshimeve dhe mbledhjes së informacioneve si kompetencë policore në procedurën parapenale. Metodologjia duhet të mundësojë edhe harmonizim terminologjik me standarde të vendeve anëtare të BE-së.

- **Sistem masash për integritet të të punësuarve dhe të masave anti-korruptive, korniza për menaxhim me resurset njerëzore. Kriteria të verifikuara për regrutim të kuadrit udhëheqës dhe themelor.**

Duke pasur parasysh nevojën e ngritjes së nivelit të kriterëve për regrutim të resurseve njerëzore në NjEKOS si dhe aplikimi të sistemit të masave për integritet të të punësuarve dhe masat anti-korruptive, do të bëhet vlerësim për rrezikun e paraqitjes së korrupsionit në vendet e punës në NjEKOS.

- **Shpërblimi material teknik dhe qendra koordinative nacionale për luftë kundër krimit të organizuar**

- Aktet juridike të domosdoshme për funksionimin e kësaj qendre u hartuan, u siguruan hapësira



adekuate në MPB

- Në nëntor të vitit 2017 është bërë setimi i kompjuterëve dhe ndërlidhja e tyre përmes VPN koneksionit me serverët e Drejtorisë së Doganave, Drejtorisë së të Hyrave Publike me qasje tek baza e tyre e të dhënave. Njëkohësisht është bërë setimi i kompjuterëve të Drejtorisë së Policisë Financiare me qasje tek mail-serveri i institucionit amë.
 - Institucionet kompetente nominuan përfaqësues të tyre në Qendrën koordinative nacionale për luftë kundër krimit të organizuar.
 - Në shkurt të vitit 2018 u mbajt punëtorja për bashkëpunim ndërinstitucional për përfaqësuesit e Qendrës koordinuese nacionale për luftë kundër krimit të organizuar, ndërkaq në mars të vitit u mbajt trajnimi themelor për inteligjencën kriminalistike.
- **Miratimi i strategjisë për forcimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë me Plan aksional**
 - Më 20 shtator të vitit 2017 u formua grupi punues nga Ministri i Punëve të Brendshme, në të cilin morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Doganave, Drejtorisë për Inteligjencës Financiare, Policisë Financiare, Prokurorisë Publike, Drejtorisë për të Hyra Publike, Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë për Menaxhim me Pasurinë e Konfiskuar, Gjykata Themelore Shkupi, 1 Shkup, Regjistri Qendror, Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive të RM dhe Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë.
 - Strategjia e Planin aksional është miratuar nga Qeveria me 27.02.2018. Strategjia përmban një sistem gjithëpërfshirës të masave ligjore e institucionale të cilat janë të domosdoshme për forcimin e kapaciteteve të përgjithshme nacionale për zhvillimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë.
 - **Nënshkrimi i memorandumit për shkëmbim të informatave për nevojat e hetimeve midis Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë Publike, dhe Gjykatës Themelore**
 - Memorandumi ndërmjet Ministrisë së Financave (Policia Financiare), Drejtoria për Inteligjencë Financiare, Drejtoria e Doganave, Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit dhe Agjencia për Pasuri të Konfiskuar, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë Publike është nënshkruar më 10.11.2017.
 - I njëjti parasheh obligimin për bashkëpunim të përmirësuar përmes shkëmbimit të të dhënave përmes platformës për interoperabilitet, aplikimin e procedurave të punës për bashkëpunim, ndihmë reciproke në luftë kundër krimit të organizuar, lehtësimin e shkëmbimit të informatave teknike dhe operative, realizimin e hetimeve të përbashkëta, trajnime të përbashkëta.
 - **Implementimi i rekomandimeve të GREKO-s nga rrethi i IV i evaluimit, të cilat deri më tani nuk janë implementuar, ndërkaq kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit tek deputetët gjykatësit dhe prokurorët publik**
 - Më 09.01.2018 Qeveria miratoi informatën për realizimin e rekomandimeve të GREKO-s (Grup shtetesh kundër korrupsionit) të Këshillit të Evropës, që jepen me raportin për evaluim të Republikës së Maqedonisë - Rrethi i katërt me temë "Parandalimi i korrupsionit tek anëtarët e Parlamentit, gjykatësit dhe prokurorët dhe anëtarët e familjeve të tyre".
 - Më 31.01.2018 është dërguar informata tek GREKO për statusin e realizimit të rekomandimeve të rrethit të katërt (raporti i dytë për situatën - në bazë të cilit GREKO duhet të miratojë Raport të dytë për harmonizim - me të cilin përmbillet rrethi i evaluimit për shtetin).
 - Në pajtim me Raportin e Parë - rrethi i 4, të miratuar në korrik 2016 nga gjithsej 19 rekomandime (4 kanë të bëjnë me Parlamentin, 9 me Gjyqësorin, 3 me Prokurorinë Publike dhe 3 për të gjitha kategoritë) - tërësisht janë implementuar 3 rekomandime (në pjesën e



PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018

gjyqësorit - 2 rekomandime), në pjesën e të gjitha kategorive 1 rekomandim), - pjesërisht janë implementuar 10 rekomandime, nuk janë implementuar 6 rekomandime.

- Rekomandimet që kanë të bëjnë me Parlamentin, do të implementohen përmes miratimit të Kodeksit etik të Parlamentit i cili tash më është në versionin punues.
- Rekomandimet që kanë të bëjnë me gjyqësorin do të implementohen përmes miratimit të pakos së ligjeve gjyqësore
- Rekomandimet që kanë të bëjnë me prokurorinë, do të realizohen përmes miratimit të ligjeve për prokurorinë publike, ndërsaq të tjerat përmes implementimit të kodeksit etik të prokurorëve publik, gjendja finale e shkallës së rekomandimeve do të bëhet në qershorë të vitit 2018 sepse në mbledhjen plenare të GREKO-s e cila do të mbahet nga fundi i qershorit do të miratohet raporti i dytë për harmonizim i RM - Rrethi i katërt në të cilin do të konstatohet gjendja finale dhe do të përmbyllet ky rreth i evaluimit për vendin.



ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

RAPORTI FAKTOGRAFIK PËR IMPLEMENTIMIN E:

PLANIT 3-6-9

NGA 4 KORRIKU 2017 – 17 PRILL 2018





7. Mediat

Mediat dhe gazetarët si shtyllë e një shoqërie demokratike kanë përkrahje të fuqishme nga Qeveria e cila është e përcaktuar fuqishëm kah **respektimi i lirisë së shprehjes**, për punë profesionale dhe objektive të mediave dhe gazetarëve, pa kurrfar ndikimi politik, presion apo dhunë të çfarëdo lloji. Qeveria është e përkushtuar drejtë krijimit të kushteve për **pavarësi të plotë dhe profesionalizim të servisit publik radiodifuziv (TVM)** dhe pavarësi të plotë dhe çlirim nga çfarëdo ndikimi ndaj Agjencisë rregullatore për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale. Qeveria ndërton partneritet me shoqatat e mediave dhe sektoin civil, me qëllim që të sigurohen kushte për punë objektive dhe të paanshme të të gjitha mediave etj, sepse është interes i të gjithë qytetarëve që të informohen saktë dhe në kohë. Qeveria filloi **proces të gjërë konsultimesh me bashkësinë e mediave dhe organizatat civile** për ndryshime të mundshme të Ligjit për Çasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik dhe Ligjit për media, si dhe masat e mundshme për lehtësimin e punës së mediave të shtypura.

- **Miratimi i deklaratës për shprehje të vullnetit të fuqishm politik dhe përkrahje nga Qeveria dhe institucionet për zbatim të vazhdueshëm të Kodeksit etik për informim mediatik.**
 - Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 05.09.2017 solli konkluzion përmes të cilit miratoi këtë deklaratë: Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet e saj shprehin vullnet të fuqishëm politik dhe përkrahje për zbatim kontinuitiv të kodeksit etik për informim mediatik dhe fuqishëm e inkurajon zbatimin dhe respektimin e sistemit për vetrregullim mediatik.
- **Mbajtja e brifingjeve javore të Qeverisë me mediat.**
 - Më 17.08.2017 në Qeveri u mbajt mbrifingu i parë para gazetarëve dhe redaktorëve, në të cilin u prezentuan idetë për punën e sektorit për komunikim i cili do të funksionojë si servis për qytetarët dhe mediat. Rendi i ditës i mbledhjeve të Qeverisë, konkluzionet dhe komunikatat shpallen në mënyrë transparente në web faqe. Pas çdo mbledhjeje të Qeverisë mbahen brifingje me qëllim që menjëherë të informohet opinioni për punën e Qeverisë. Këto brifingje u shndëruan në pres konfrenca publike, të cilat transmetohen drejtëpërdrejtë, e në të cilat gazetarët kanë mundësi të parashtrajnë pyetje lidhur me vendimet e qeverisë, por edhe për të gjitha informatat plotësuese jashtë temës.
- **Përgatitja e pasqyrës së të gjitha rasteve të deritanishme të sulmeve fizike, verbale dhe presioneve, gjuhës së urrejtjes e të ngjashme ndaj gazetarëve**
 - Në bazë të Raportit të përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme për periudhën 2013-qershor 2017, janë regjistruar raste të dhunës fizike dhe verbale dhe presione ndaj gazetarëve, janë parashtruar gjithsej 44 paraqitje nga qytetarët ose mediat për sulme fizike ndaj gazetarëve, duke rezikuar sigurinë në formë të kanosjeve të çdo lloji ose gjuhës së urrejtjes. Pjesa më e madhe e paraqitjeve janë në nga rajoni i Shkupit - 28, pastaj Ohri - 14 dhe dy ankesa nga rajoni i Strumicës.
- **Sjellja e vendimit të Qeverisë për ndalimin e reklamave qeveritare në rediodifuzionet komerciale (me përjashtim të mediave sociale) dhe përcjellja e komunikimit me qytetarët përmes servisit publik radiodifuziv.**
 - Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 22.08.2017 solli konkluzion sipas të cilit obligohen të gjitha organet e administratës shtetërore, u bëhet me die institucioneve të cilat nuk kanë status të organit të administratës shtetërore dhe u rekomandohet njësitve të vetëqeverisjes lokale të ndërprejnë emetimin, përkatësisht të fushatave, spoteve dhe të hapësirave të paguara në radiodifuzerët elektronik komercial - televizione dhe radio, gazeta javore dhe ditore, bilborde,



portale interneti, me përjashtim të mediave sociale.

- **Publikimi i të gjitha shpenzimeve të Qeverisë dhe shpjegim i kriterëve për zgjedhje të mediave për periudhën 2008-2017, në formatin e dërguar nga Komisioni Evropian.**
 - Më 24.09.2017 zëdhënësi i Qeverisë mbajti pres konferencë ku u publikuan shpenzimet për reklamim të Qeverisë për periudhën 2008-2015. Lidhur me ndarjen e mjeteve, siç u shpjegua në pres konferencë, janë të paqarta kriteret se si janë bartur paratë për blerje të hapësirës për reklama tek koncesionerët komercial dhe nacional, edhe pse pasqyra tabelare e prezentuar në konferencë për media, tregon se rejtingu nuk ka luajtur kurrfarë roli ose kriteret thjeshtë nuk kanë ekzistuar. Në mënyrë plotësuese në konferencë, më 16.09.2017, në kuadër të analizës së shpenzimeve për tërheqje të investimeve të jashtme kreditore në 10 vitet e fundit, u prezentuan edhe shpenzimet që u janë paguar mediave të Maqedonisë.
- **Mbajtja e konsultimit publik me mediat, shoqatat e mediave dhe shoqatat civile**
 - Diskutimi i parë publik në temën e reformave mediatike u mbajt me 14 korrik 2017, në të cilin morën pjesë Ministri për Shoqëri Informatike dhe Administratë dhe Ministri pa Resor i Angazhuar për Komunikime, Llogaridhënie dhe Transparencë. Ministrat realizuan edhe disa takime veçmas me përfaqësues të mediave dhe të shoqatave të mediave si dhe me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare.
- **Hapja e dialogut me bashkësinë mediatike dhe organizatat civile për ndryshimet e mundshme të Ligjit për çasje të lirë deri tek informacionet e karakterit publik**
 - Më 19.12.2017 u mbajt debat për nevojën e ndryshimeve të Ligjit për çasje të lirë tek informacionet e karakterit publik në organizim të Ministrisë së Drejtësisë me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë dhe Ministrin pa Resor për Komunikime, Llogaridhënie dhe Transparencë.
 - Pjesëmarrësit dhanë propozime, sugjerime dhe vërejtje lidhur me zbatimin praktik të zgjidhjeve aktuale ligjore por edhe për zgjidhjet e mundshme për tejkalimin e gjendjes së konstatuar.
 - Përgjithësisht, të gjitha komentet dhe propozimet ishin në drejtim të sigurimit të transparencës më të madhe aktive, sidomos përmes përmirësimit të zbatimit të nenit 10 të Ligjit, i cili përmban obligimin që e ka barta i informacionit për informim të opinionit.
 - U theksua edhe nevoja për rritjen e kapaciteteit të buxhetit të Komisionit për mbrojtjen e së drejtës për çasje të lirë tek informacionet e karakterit publik, si rritje e ingjencave të saj me mundësi për shqiptim të sanksioneve për kundërvajtje dhe aplikim të përgjegjësisë për administratën, për mosrespektim të dispozitave ligjore që drejtëpërsëdrejti do të reflektohej në efektin e implementimit të këtyre dispozitave.
 - Arritën disa propozime edhe në formë të shkruar deri tek ministria e drejtësisë. Më 14.02.2018 në ENER është shpallur njoftimi për fillim të procesit të përgatitjes së Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për çasje të lirë tek informacionet e karakterit publik.
 - Është formuar grup punues i ekspertëve dhe përfaqësuesve të të gjitha palëve të tanguara dhe është përgatitur projekt plan i versionit fillestar të Propozim-Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për çasje të lirë tek informacionet e karakterit publik.
- **Hapje e diskutimit publik për ndryshime të mundshme të Ligjit për media,**
 - Më 21.12.2017 u mbajt debat me temë "Verifikimi i nevojës për ndryshime të mundshme të Ligjit për media" me përfaqësuesit e pjesës dërmuese të mediave, gazetarëve dhe shoqatave mediatike, si dhe individëve nga sfera e mediave, të cilin e organizoi Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë dhe Ministri pa resor për Komunikime, Llogaridhënie dhe



Transparencë.

- Në pajtim me konkluzionin nga debati duhej të dërgoheshin argumente për dhe kundër ndryshimit të ligjit në formë të shkruar më së voni deri më 30.01.2018, e pas kësaj do të pasonte edhe një cikël i debateve publike nga i cili do të dilnin vendimet përkatëse. Procesi i konsultimeve vazhdon me të gjitha palët e interesuara.

• **Hapja e debatit publik për masa të mundshme për lehtësimin e punës së mediave të shtypit**

- Debati publik për atë se nëse ka nevojë dhe cili është modeli më i mirë për përkrahje të mediave të shkruara, si pjesë e përpjekjeve për pluralizëm në zgjedhjen mediatike për qytetarët u mbajt me 18.12.2017 në organizim të Ministrisë pa resor për Komunikime, Logaridhënie dhe Transparencë, dhe Kryetarit të Shoqatës së re të formuar për mbrojtje të mediave të shkruara.
- U hapën qështje nëse Qeveria duhet t'i subvencionojë edhe gazetatat të cilat janë pa pagesë dhe gazetatat të cilat merren me tematikë profesionale dhe specifike, nëse duhet përgjithësisht të jepet ndihmë mediave të shkruara, për faktin se trend botëror është rritja e mediave digjitale dhe zhdukja e mediave të shkruara. Një pjesë e propozimeve fillestare për përkrahje, kanë të bëjnë me subvencionimin prej 50% të shpenzimeve të botimit dhe të distribuimit të mediave ditore, javore dhe mujore, me karakter informativ, si dhe ndihmë prej 20% për mediat e bashkësive më të vogla etnike. Procesi konsultativ po vazhdon, po shqyrtohen të gjitha propozimet e dërguara nga shoqatat e mediave, po analizohen edhe përvojat e vendeve të BE-së, me qëllim që të gjendet modaliteti më i mirë për përkrahje të mediave të shtypura.

• **Miratimi i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuele**

- Në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur më 19.09.2017, me qëllim që të shfuqizohet obligimi i qytetarëve dhe firmave për pagesë të taksës radio-difuzive, me procedurë të shkurtër u sollën ndryshimet e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuele. TVM do të përkrahet financiarisht nga buxheti shtetëror me një ndarje prej 07% nga buxheti për vitin 2018, 08 për vitin 2019, 09 për vitin 2020, ndërkaq duke filluar nga viti 2021, kjo shumë do të jetë 1% e buxhetit të RM.
- Në drejtim të reformimit gjithëpërfshirës në sferën mediatike, pas konsultimeve të mbajtura publike, u duërgua thirrje derti tek të gjitha palët e tanguara për dërgimin e propozimeve për ndryshim të Ligjit për shërbime audio dhe audio vizuele mediatike. Në bazë të komenteve dhe propozimeve të pranuar, MShIA në koordinim me Ministrinë pa resor për Komunikime Logaridhënie dhe Transparencë, pregaditën propozim tekstin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audio vizuele, i cili ju dërgua të gjitha palëve të tanguara dhe u vendos në web faqen e MShIA. Afati i dërgimit të komenteve nga palët e tanguara lidhur me propozim tekstin e Ligjit ishte deri më 11.09.2017.
- Më 20.11.2017 u mbajt diskutimi publik për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audio vizuele me përfaqësues të mediave, shoqatave mediatike dhe organizatave civile.
- Projekt Ligji u shpall në ENER më 30.11.2017 dhe një pjesë e komenteve të marra janë integruar në tekst.
- Me 26.12.2017, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë e publikoi versionin e fundit të Projekt ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audio vizuele, i përgatitur në bashkëpunim me përfaqësuesit e sferës mediatike, para se i njëjti të hyjë në procedurë qeveritare. Propozim Ligji i është dërguar KE-së dhe OSBE-së për mendim.



- Ndër ndryshimet më të rëndësishme janë:
 - Anëtarët e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, do të angazhohen profesionalisht në Agjencion dhe do të marrin kompensim mujor në lartësi prej më së shumti katër pagave mesatare mujore të paguara në Maqedoni.
 - Anëtarët do të kenë mandat pesëvjeçar, me të drejtë që të zgjedhen edhe një mandat.
 - Konkretisht janë definuar mënyrat me të cilat Këshilli do të mund të inicojë procedurë për kundërvajtje, ndaj mediave apo operatorëve të rrjeteve publike elektronike për komunikim.
 - Ndalesë për emetim të programeve të cilat, përveç se rrezikojnë sigurinë nacionale ose nxisin rrënim të dhunshëm të rendit kushtetues ose konflikt të armatosur, përmbajnë diskriminim ose përhapin jotolerancë dhe urrejtje në çfarëdo baze.
 - Programet e radiove dhe televizioneve gjatë një dite do të duhet të inkorporojnë 30% program burimor të krijuar si vepër të Maqedonisë, ndërsa për Radio Televizionin e Maqedonisë kjo përqindje do të jetë 40%.
 - Nga paratë shtetërore 74,5% do të shkojnë për RTVM, 19,5% për Radiodifuzionin e Maqedonisë, ndërsa 6% për Agjencionin.
 - Burim plotësues i mjeteve për financimin e RTVM janë donacionet, shitja e programeve dhe shërbimeve, si dhe mjeteve të realizuara nga emetimi i komunikimeve audio dhe audiovizuale komerciale të emituara në kuadër të përmbajtjeve të siguruara në bazë të kontratave të veçanta të lidhura me sigures të veprave audio dhe audiovizuale, me të drejta të mbrojtura të autorëve, në pajtim me kushtet e kontratës.
